



Dokumenti i Mbrojtjes së Fëmijëve për Menaxhimin e Rastit në Kontekstin Humanitar



Dokumenti i Mbrojtjes së Fëmijëve për Menaxhimin e Rastit në Kontekstin Humanitar



Manuali u hartua nga:

Prof. Assoc. Irida Agolli, Eksperte vendore

Ky dokument është publikuar në kuadër të projektit “Refugjatët, veçanërisht fëmijët dhe gratë, kanë akses në shërbime të parandalimit dhe përgjigjes cilësore kundër abuzimit, dhunës dhe neglizhimit”.

Financuar nga UNICEF, zbatuar nga Nisma Arsis në bashkëpunim dhe Terre des hommes dhe Plan and Go.

Fëmijët migrantë – qofshin të shoqëruar (nga anëtarë të familjes, të rritur të besuar, ose një grup adoleshentësh dhe të rinjsh me të cilët janë bashkuar gjatë rrugës), të pashoqëruar ose të ndarë nga familja dhe miqtë – konsiderohen si të pambrojtur. Kjo cenueshmëri mund të jetë edhe pasojë e situatës– që rrjedh nga varësia e tyre nga rrugët e parregullta të migrimit, kontrabandistët, etj. – dhe/ose i natyrshëm në statusin e tyre si fëmijë.

Fëmijët e pashoqëruar ose të ndarë janë veçanërisht të cenueshëm dhe sfidat me të cilat përballen kërkojnë përgjigje të veçanta. Është e vështirë të merren shifra të sakta globale në lidhje me numrin e fëmijëve që udhëtojnë të pavarur, por numri i tyre është në rritje. Shumë fëmijë të pashoqëruar ose të ndarë nuk regjistrohen tek autoritetet, sepse nuk janë në gjendje, kanë frikë ta bëjnë këtë ose sepse janë këshilluar nga familja, bashkëmoshatarët ose kontrabandistët që të vazhdojnë lëvizjen për në një destinacion tjetër. Të tjerë ende nuk lejohen të kontaktojnë autoritetet, pasi kontrollohen nga trafikantët dhe janë të destinuar për shfrytëzim seksual, punë ose qëllime të tjera.

Mbijetesja e fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë mund të kërcënohet në konflikt të armatosur ose fatkeqësi të tjera. Këtyre fëmijëve kanë më shumë gjasa t'u shkelen të drejtat themelore dhe të rrezikojnë abuzimin, shfrytëzimin ose rekrutimin në forcat e armatosura. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë për mbrojtje dhe përkujdesje sipas një game të gjerë instrumentesh ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare. Me rëndësi të veçantë për fëmijët e ndarë janë:

- e drejta për një emër, identitet ligjor dhe regjistrimi i lindjes;
- e drejta për mbrojtje fizike dhe ligjore;
- e drejta për të mos u ndarë nga prindërit;
- e drejta për furnizime për jetesën e tyre bazë;
- e drejta për kujdes dhe ndihmë të përshtatshme për moshën dhe nevojat e tyre zhvillimore;
- e drejta për të marrë pjesë në vendimet për të ardhmen e tyre.

Përgjegjësia kryesore për të siguruar mbijetesën dhe mirëqenien e fëmijëve bie mbi prindërit, familjen dhe komunitetin. Autoritetet kombëtare dhe vendore janë përgjegjëse për të garantuar respektimin e të drejtave të fëmijëve. Institucionet përgjegjëse dhe të gjithë aktorët përgjegjës duhet të bëjnë përpjekje në raste urgjente për të mbrojtur unitetin e familjes dhe për të shmangur ndarjen fëmijë-familje.

Ky dokument është shkruar për të gjithë aktorët që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, dhe prezanton një qasje të strukturuar për identifikimin dhe mbështetjen e fëmijëve refugjatë/migrantë veçanërisht të cenueshëm (fëmijët e e pashoqëruar ose të ndarë). Qëllimi i dokumentit është të sigurohet që të gjithë palët e interesuara të kenë të njëjtin kuptim për rreziqet me të cilat përballen fëmijët në raste urgjente dhe të sigurohet që fëmijët të marrin mbështetjen e duhur në të gjitha situatat kur kërkohet.

Përkufizimet sipas Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

“Agjencia” nënkupton Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

“Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të këtij ligji, derisa mosha e tij të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

“Fëmijë i pashoqëruar” është fëmija që është ndarë nga të dy prindërit ose të afërmit e tjerë të familjes dhe për të cilin nuk kujdeset ndonjë person madhor, sipas këtij ligji.

“Fëmijë në nevojë për mbrojtje” është personi nën moshën 18 vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, individi nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer një vepër penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin.

“Mbrojtje e fëmijës” është parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijës, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës.

“Ndëshkimi trupor” është çdo lloj ndëshkimi që përdor forcën fizike dhe që synon të shkaktojë dhimbje ose shqetësim të fëmija, nga çdo person ligjërish përgjegjës për fëmijën.

Ndëshkimi trupor përfshin forma të tilla, si: rrahja, tortura, shkundja, shtytja, djegia, goditja, pickimi, çjerrja, kafshimi, qortimi i rreptë, tërheqja e flokëve, detyrimi me forcë për të kryer një veprim, përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim, si dhe çdo veprim i ngjashëm me të.

“Neglizhimi i fëmijës” është mosveprimi me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës.

Fëmijë të pashoqëruar: “janë ata fëmijë që janë ndarë nga të dy prindërit dhe të afërmit e tjerë dhe për ta nuk kujdeset një i rritur, i cili, sipas ligjit është përgjegjës për ta bërë këtë.¹”

Fëmijë të ndarë: “Të ndarë nga të dy prindërit, ose nga kujdestari i tyre, por jo domosdoshmërisht të afërm të tjerë. Prandaj, këta mund të përfshijnë fëmijë të shoqëruar nga anëtarë të tjerë të rritur të familjes.²”

Termi “interesat më të larta të fëmijës” përshkruan gjerësisht mirëqenien e një fëmije. Një mirëqenie e tillë përcaktohet nga një sërë rrethanash individuale (si gjinia, mosha, niveli i pjekurisë dhe përvojat e tyre) dhe faktorë të tjerë (si prania ose mungesa e prindërve, cilësia e marrëdhënieve midis fëmijës dhe familjes/kujdestarit, dhe rreziqe të tjera). Ekzistojnë tre aspekte të konceptit të interesit më të mirë. Ato janë:³

¹ Field Handbook on Unaccompanied and Separated Children. Inter-agency Working Group on Unaccompanied and Separated Children. Alliance for Child Protection in Humanitarian Action. 2017

² Field Handbook on Unaccompanied and Separated Children. Inter-agency Working Group on Unaccompanied and Separated Children. Alliance for Child Protection in Humanitarian Action. 2017

³ The Alliance for Child Protection in Humanitarian Action, 2019. Minimum Standards for Child Protection in Humanitarian Action.

- E drejta themelore e fëmijës: fëmijët kanë të drejtë që interesat e tyre më të mira të vlerësohen dhe të merren si konsideratë parësore;
- Një parim ligjor: nëse një dispozitë ligjore është e hapur për më shumë se një interpretim, duhet të zgjidhet interpretimi që i shërben në mënyrë më efektive interesave më të larta të fëmijës;
- Rregulli i procedurës: sa herë që një vendim do të prekë një fëmijë, një grup fëmijësh ose fëmijë në përgjithësi, procesi i vendimmarrjes duhet (a) të vlerësojë ndikimin e mundshëm të vendimit mbi fëmijën/fëmijët në fjalë dhe (b) të tregojë se e drejta e fëmijëve duke marrë si konsideratë parësore interesat e tyre më të mira është marrë në konsideratë në mënyrë eksplicitet qartë.

Ligji nr. 18/2017, është përpjekur të përcaktojë edhe kuptimin e interesit më të lartë të fëmijës, që nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh: a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri, si dhe rritjen/përkatësinë në një familje; b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar; c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen; ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës; d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.

Një **vlerësim i interesit më të lartë (BIA)**⁴ është një vlerësim i bërë nga stafi që merr masa në lidhje me fëmijët, përveç rasteve kur kërkohet një BID i projektuar për të siguruar që një veprim i tillë i jep një konsideratë parësore interesit më të mirë të fëmijës. Vlerësimi mund të bëhet i vetëm ose në konsultim me të tjerët nga personeli me ekspertizën e kërkuar dhe kërkon pjesëmarrjen e fëmijës.

Përcaktimi i interesit më të lartë (BID)⁵ përshkruan procesin formal me masat mbrojtëse procedurale të rrepta, të krijuara për të përcaktuar interesat më të mira të fëmijës për vendime veçanërisht të rëndësishme që e prekin atë. Ai duhet të lehtësojë pjesëmarrjen adekuate të fëmijëve pa diskriminim, të përfshijë vendimmarrësit me fushat përkatëse të ekspertizës dhe të balancojë të gjithë faktorët përkatës në mënyrë që të vlerësohet alternativa më e mirë.

KDF ofron gjithashtu një kornizë më të gjerë për t'u marrë parasysh në procesin e përcaktimit të interesit më të lartë. Nenet e mëposhtme të KDF-së janë veçanërisht të rëndësishme⁶:

Neni 9: Fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë

1. (...) një fëmijë nuk duhet të ndahet nga prindërit e tij ose të saj kundër vullnetit të tyre, përveç kur autoritetet kompetente që i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor përcaktojnë, (...) , se një ndarje e tillë është e nevojshme për interesat më të larta të fëmijës. Një përcaktim i tillë mund të jetë i nevojshëm në një rast të veçantë si ai që përfshin abuzimin ose neglizhimin e fëmijës nga prindërit, ose kur prindërit jetojnë të ndarë dhe duhet të merret një vendim për vendbanimin e fëmijës.
2. (...) të gjitha palëve të interesuara do t'u jepet mundësia të marrin pjesë në seancë dhe të bëjnë të njohura pikëpamjet e tyre.
3. Shtetet Palë do të respektojnë të drejtën e fëmijës që është i ndarë nga njëri ose të dy prindërit për të mbajtur rregullisht marrëdhënie personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me të dy prindërit, përveç nëse kjo është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës.

⁴ UNCHR (2018). GUIDELINES ON ASSESSING AND DETERMINING THE BEST INTERESTS OF THE CHILD

⁵ UNCHR (2018). GUIDELINES ON ASSESSING AND DETERMINING THE BEST INTERESTS OF THE CHILD

⁶ UN General Assembly, Convention on the Rights of the Child, G.A. res. 44/25, annex, 44 U.N. GAOR Supp. (No. 49) at 167, U.N. Doc. A/44/49 (1989).

4. Kur një ndarje e tillë rezulton nga ndonjë veprim i nisur nga një Shtet Palë, si ndalimi, burgimi, internimi, dëbimi ose vdekja (...) e njërit ose të dy prindërve ose e fëmijës, ai Shtet Palë, me kërkesë, do të sigurojë prindërit, fëmijën ose, nëse është e përshtatshme, një anëtar tjetër të familjes me informacionin thelbësor në lidhje me vendndodhjen e anëtarit (ve) që mungojnë në familje, përveç rasteve kur dhënia e informacionit do të ishte e dëmshme për mirëqenien e fëmijës. (...)

Parimet udhëzuese

Parimet e të drejtave të fëmijëve në lidhje me fëmijët e pashoqëruar, të ndarë⁷.

Uniteti i familjes – ose integriteti i familjes – u jep të gjithë fëmijëve të drejtën për familje dhe familjeve të drejtën për t'u kujdesur për fëmijët e tyre. Fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë duhet t'u ofrohen shërbime që synojnë ribashkimin e tyre me prindërit ose kujdestarët kryesorë ligjorë ose zakonorë sa më shpejt të jetë e mundur, nëse kjo është në interesin e tyre më të lartë.

Interesi më i lartë i fëmijës përbën standardin bazë për drejtimin e vendimeve dhe veprimeve që prekin fëmijët, qoftë nga organizatat kombëtare apo ndërkombëtare, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislativë.

E drejta për jetën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës u jep të drejtë të gjithë fëmijëve, duke përfshirë fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë, të kenë jetë të mbrojtur dhe që ata të rriten dhe zhvillohen në mënyrë të shëndetshme, duke përfshirë qasjen në burimet e nevojshme për të arritur potencialin e tyre maksimal njerëzor.

Pjesëmarrja dhe respekti për pikëpamjet e fëmijës nënvizon se të gjithë djemtë dhe vajzat duhet të jenë në gjendje të shprehin pikëpamjet e tyre dhe se këto pikëpamje duhet të respektohen dhe t'u jepet pesha e duhur në lidhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës. Fëmijët duhet të mbahen të informuar dhe, për aq sa është e mundur, të përfshihen në vendimmarrje dhe plane në lidhje me vendosjen, kujdesin, gjurmimin dhe ribashkimin e tyre. Programet duhet t'i angazhojnë fëmijët në mënyrë aktive në parandalimin dhe reagimin ndaj ndarjes së familjes.

Mosdiskriminimi, një parim bazë i të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe të drejtës humanitare, përcakton se mbrojtja dhe garancitë e së drejtës ndërkombëtare duhet t'u jepen të gjithëve, pavarësisht nga kombësia, etnia, gjinia, moshja, aftësia ose statusi tjetër. Kjo përfshin, në veçanti, vajzat dhe nevojat e tyre specifike, siç parashikohet në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, Konventat e Gjenevës dhe Protokollet e tyre Shtesë.

⁷Field Handbook on Unaccompanied and Separated Children. Inter-agency Working Group on Unaccompanied and Separated Children. Alliance for Child Protection in Humanitarian Action. 2017

Konfidencialiteti, pëlqimi i informuar për fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë

Konfidencialiteti

Konfidencialiteti duhet të jetë një element parësor kur punoni me fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë. Konfidencialiteti është i rëndësishëm për t'i mbajtur fëmijët të sigurt, për të mbrojtur dinjitetin dhe mirëqenien e tyre dhe për krijimin dhe ruajtjen e besimit. Kjo do të thotë, për shembull, të mos shkruani emrin e një fëmije në pjesën e jashtme të një dosje ose në foton e tij/saj, ose të diskutoni në mënyrë të panevojshme situatën e një fëmije me ata që nuk kanë nevojë të kenë informacion për qëllime identifikimi, dokumentacioni, gjurmimi, ribashkimi ose mbrojtjeje. Megjithatë, konfidencialiteti nuk do të thotë të mos diskutosh kurrë për rastin. Për shembull, punonjësit e mbrojtjes mund të kenë nevojë të diskutojnë rastet me profesionistët, ose punonjësit e tjerë të rasteve.

Shumicën e kohës, marrëveshja ose pëlqimi merret nga një fëmijë/kujdestar për të ndarë informacionin me të tjerët. Megjithatë, në disa raste, informacioni ndahet pa marrëveshje; në të vërtetë, respektimi i interesave më të mira të fëmijës ndonjëherë mund të nënkuptojë tejkalimin e dëshirës së tyre për ta mbajtur informacionin konfidencial. Në rrethana të tilla, zbatohet "konfidencialiteti i kufizuar". "Konfidencialiteti i kufizuar" i referohet situatave në të cilat mund të ketë detyrime ligjore ose të tjera që tejkalojnë të drejtën e individit për konfidencialitet. Konfidencialiteti i kufizuar zbatohet kur:

- Ka shqetësime për sigurinë dhe mirëqenien e një fëmije/të riu që kërkojnë ndarjen e informacionit (për shembull, me ofruesit përkatës të shërbimeve).
- Është kryer një vepër penale dhe ligjet e detyrojnë raportimin e saj tek policia ose autoritetet e tjera (sipas ligjeve për raportimin e detyrueshëm).

Institucionet që punojnë me fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë duhet të jenë të vetëdijshme për çdo kërkesë të detyrueshme raportimi në kontekstin e tyre dhe për nivelin e mbrojtjes ligjore që gëzojnë ato dhe anëtarët e stafit të tyre në atë vend (imunitet nga proceset ligjore). "Kur ka shqetësime se disa aktorë mund të mos jenë në gjendje të ruajnë konfidencialitetin, ose nëse raportimi mund t'i rrezikojë ata ose fëmijën, vendimet duhet të merren rast pas rasti dhe duhet të udhëhiqen mbi të gjitha nga interesi më i lartë i fëmijës".

Kur merret pëlqimi i informuar, ligjet dhe kufijtë e konfidencialitetit të secilit institucion, duke përfshirë kërkesat e detyrueshme të raportimit, duhet t'i shpjegohen siç duhet fëmijës/kujdestarit.

Pëlqimi i informuar për fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë

Përpara se të vazhdohet me dokumentacionin, menaxhimin e rastit dhe çdo veprim tjetër që lidhet me kujdesin dhe mbrojtjen (për shembull, referimet), është e nevojshme të merret “pëlqimi i informuar” nga fëmija.

Pëlqimi i informuar: “Marrëveshja vullnetare e një individi që ka aftësinë për të dhënë pëlqimin dhe që ushtron pushtetin e lirë të zgjedhjes. Për të dhënë “pëlqimin e informuar” individi duhet të jetë në gjendje të kuptojë dhe të marrë një vendim në lidhje me situatën e tij. Pëlqimi i informuar mund të kërkohej nga një fëmijë ose nga kujdestari i fëmijës⁸ sipas moshës së fëmijës dhe nivelit të tij të pjekurisë”.

“Pëlqimi i informuar⁹ është gatishmëria e shprehur për të marrë pjesë në shërbime. Për fëmijët më të vegjël, të cilët sipas definicionit janë shumë të vegjël për të dhënë pëlqimin e informuar, por mjaft të rritur për të kuptuar dhe pranuar të marrin pjesë në shërbime, kërkohej “aprovim i informuar” i fëmijës”.

Pëlqimi, ose nëse pëlqimi nuk është i mundur, një nga bazat ligjore alternative, mund të nevojitet nga fëmija dhe/ose kujdestari në faza të ndryshme të procesit të menaxhimit të rastit për veprime ose vendime të ndryshme. Për shembull, duhet të merret pëlqimi për leje për të kryer një intervistë, për leje për të ndarë informacionin për qëllime të ofrimit të shërbimit, etj. Për më tepër, pëlqimi do të kërkohej gjithashtu në lidhje me shërbimet e ndryshme të ofruara për fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë - për shembull, për ribashkim ose për regjistrim në një aktivitet të caktuar.

1. Pëlqimi për përpunimin e të dhënave personale

Skenari A: Fëmija është në gjendje të japë pëlqimin

E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale është pjesë e të drejtave themelore për mbrojtjen e jetës private (përfshirë jetën familjare, shtëpinë dhe korrespondencën) të një individi kundër ndërhyrjeve nga të tjerët. Ndër të tjera, e drejta për mbrojtjen e të dhënave kërkon që të krijohet një bazë e qartë ligjore gjatë mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale.

Pëlqimi është baza ligjore e preferuar për përpunimin e të dhënave personale (si regjistrimi i një personi, shkëmbimi ose transferimi i informacionit personal te një palë e tretë, etj.) sa herë që përfituesi është në gjendje të ofrojë një tregues të dhënë lirisht, specifik, dhe dëshira të informuara. Pëlqimi mund të jepet ose nëpërmjet një deklarate me shkrim, me gojë ose një deklaratë tjetër ose me një veprim të qartë afirmativ nga përfituesi që nënkupton pranimin e tij/saj që të dhënat e tij/saj personale të përpunohen. Është e rëndësishme që në marrjen e këtij vendimi, përfituesi të jetë në gjendje të marrë parasysh plotësisht rreziqet dhe përfitimet e procedurës së përpunimit.

Për të përcaktuar nëse individi në fjalë është në gjendje të japë pëlqimin, duhet të merren parasysh elementët e ndryshëm të mundshëm të cënueshmërisë që mund të ndikojnë tek ai/ajo. Moshë është një prej tyre. Nuk ka një “moshë ligjore të pëlqimit” të prerë.

⁸(Child Protection Working Group, Minimum Standards for Child Protection in Humanitarian Action, 2012, Standard 5: 'Information Management', p. 66, 67.)

⁹International Rescue Committee and UNICEF, Caring for Child Survivors of Sexual Abuse: Guidelines for health and psychosocial service providers in humanitarian settings, 2012, p. 16.

Vende të ndryshme mund të kenë rregulla të ndryshme për këtë temë (në shumicën e rasteve nuk ekzistojnë rregulla të tilla). Më e rëndësishmja, niveli i pjekurisë së fëmijëve ndryshon nga konteksti në kontekst dhe nga fëmija në fëmijë. Në disa kontekste, përfituesit mund të mos jenë në dijeni të datës së saktë të lindjes ose të mos kenë informacion të saktë për moshën e tyre.

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës duhet të kërkojë pëlqimin e informuar, duke shpjeguar me gjuhë të thjeshtë dhe të përshtatshme për moshën, pse kërkohet informacioni dhe për çfarë do të përdoret ai, duke përfshirë mënyrën se si do të shpërndahet. "I informuar" do të thotë që fëmija e kupton me të vërtetë rëndësinë dhe rreziqet e përfshira në çdo veprim që mund të ndërmerret dhe se vendimi i tij/saj merret duke u mbështetur në një informacion të plotë. Po kështu, institucionet duhet të ndërmarrin një analizë rreziku se çfarë do të thotë për stafet ndërmarrja e veprimeve me pëlqimin e informuar të fëmijëve.

Përveç kësaj, pëlqimi duhet të dokumentohet dhe të specifikojë të paktën pikat e mëposhtme:

- Qëllimi i mbledhjes (për shembull, gjurmimi, referimet në shërbime, etj.)
- Shtrirja e pëlqimit (nëse ka kufizime në përpunimin ose ndarjen e të dhëna, etj.).

Skenari B: Fëmija nuk është në gjendje të japë pëlqimin

Nëse një fëmijë nuk ka gjasa të jetë në gjendje të japë një pëlqim të tillë, veçanërisht kur është shumë i vogël ose kur vendimi është shumë i rëndë që vetë fëmija të japë pëlqimin, atëherë institucionet mund të procedojnë në njërin nga dy mënyrat:

a. Përpunojnë të dhënat në interesin më të lartë/jetik dhe/ose për arsye të rëndësishme të interesit publik (ky rast vlen për organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare në kryerjen e mandatit të tyre përkatës, kur ky mandat i njihet në ligj).

Kjo do të përfshinte:

- Në rastin e interesit jetik, kur ka informacion se në mungesë të veprimit, përfituesi mund të rrezikohet nga dëmtimi i rëndë fizik ose moral.
- Në rastin e interesit më të lartë, objektivi është të merret në konsideratë ajo që është më e favorshme për mirëqenien e fëmijës për të parandaluar çdo pasojë negative që mund të rezultojë nga përpunimi i të dhënave të tij personale.
- Në rastin e situatave të rëndësishme të interesit publik, duke qenë e qartë se përpunimi specifik i të dhënave është brenda mandatit që i është dhënë organizatës ndërkombëtare sipas instrumenteve ligjore në fuqi.
- Në çdo rast, duhet t'i jepet informacion i qartë përfituesit në lidhje me procedurën e propozuar të përpunimit të të dhënave.
- Sigurimi që përfituesi ka të drejtën për të kundërshtuar.
- Sigurimi që përpunimi i të dhënave është në interesin më të mirë të individit.

b. Përpunojnë të dhënat bazuar në pëlqimin e një kujdestari.

Një kujdestar është personi që ka autoritetin për të vendosur për një fëmijë sipas ligjit kombëtar (një prind, një person i caktuar me ligj ose një i afërm).

Kjo do të përfshinte:

- Sigurimin e informacionit të plotë për kujdestarin dhe nënshkrimin e pëlqimit.
- Të sigurohet që fëmija të jetë i informuar qartë dhe të merren parasysh pikëpamjet e tij/saj.
- Sigurimi që përpunimi të jetë në interesin më të lartë të fëmijës.

Megjithatë, kjo duhet të ndodhë vetëm kur është në interesin më të lartë të fëmijës që të informojë/marrë pëlqimin nga kujdestari. Pavarësisht pëlqimit të dhënë nga një kujdestar, informacioni nuk mund të ndahet kur nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

2) Nëse pëlqimi refuzohet

A. Nëse fëmijët refuzojnë pëlqimin

Disa fëmijë mund të mos jenë të gatshëm të japin pëlqimin sepse janë të hutuar, të shqetësuar, të frikësuar, dyshues ose për arsye të tjera. Kur fëmijët refuzojnë pëlqimin për gjurmim, eksploroni butësisht arsyet e tyre dhe mbështetini ata në marrjen e një vendimi që është në interesin e tyre më të lartë, duke u siguruar që të kuptojnë procesin dhe qëllimin e përpunimit të të dhënave. Nëse ende nuk jepet pëlqimi, duhet të kryhet një vlerësim gjithëpërfshirës nga PMF për të identifikuar nëse përpunimi i të dhënave është në interesin jetik/më të lartë të fëmijës.

B. Nëse kujdestarët refuzojnë pëlqimin

Ndonjëherë kujdestarët mund të refuzojnë të japin pëlqimin në emër të një fëmije nëse nuk e kuptojnë pse informacioni ose veprimet në lidhje me fëmijën janë të nevojshme ose nëse qasja nuk është e përshtatshme kulturalisht. Kujdestarët mund të përpiqen gjithashtu të fshehin informacionin për fëmijën, veçanërisht nëse abuzojnë ose e shfrytëzojnë fëmijën. Për të trajtuar situata të tilla, stafi duhet të shpjegojë përsëri qartë se përse është mbledhur informacioni ose veprimet e ndërmarra, qëllimi për të cilin informacioni do të përdoret dhe përfitimet e mundshme për fëmijën. Në mënyrë të ngjashme, shpjegoni pasojat e mosdhënies së pëlqimit, për shembull, për shëndetin ose mirëqenien e një fëmije. Në varësi të situatës, mund të jetë e nevojshme të kërkohet ndërmjetësim nga udhëheqësit e komunitetit ose përfaqësues të institucioneve fetare. Në të gjitha situatat, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë parësor. Nëse ende nuk pranohet pëlqimi, duhet të kryhet një vlerësim gjithëpërfshirës nga PMF-ja i çështjes për të identifikuar nëse përpunimi i të dhënave është në interesin jetik/më të mirë të fëmijës.

Renditja sipas përparësisë

Kur ka ngarkesa të mëdha të numrit të fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë dhe burime të kufizuara, mund të jetë e nevojshme që stafi i lartë dhe ata që intervistojnë fëmijët t'u japin përparësi veprimeve. Përdorimi i një sistemi përparësie të vendosur si brenda ashtu edhe në organizatat përkatëse, mund të ndihmojë në menaxhimin e ngarkesave të rasteve dhe të sigurojë që gjurmimi të kryhet në mënyrë efektive dhe efikase.

Në mjediset e refugjatëve, një mënyrë efikase për t'u dhënë përparësi është të sigurohet që personeli i mbrojtjes së fëmijëve të jetë i pranishëm në pikat e regjistrimit dhe që stafi i regjistrimit të jetë i trajnuar për të identifikuar fëmijët e pashoqëruar, të ndarë. Kur identifikohen fëmijët e pashoqëruar, të

ndarë, ata mund t'u referohen punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve, të cilët mund të kryejë një vlerësim të shpejtë të interesit më të lartë për të kontrolluar dhe për t'i dhënë përparësi fëmijës.

Dhënia përparësi përfshin gjetjen e informacionit rreth rrethanave të menjëhershme të fëmijës gjatë identifikimit dhe dokumentacionit me qëllim përcaktimin e veprimeve urgjente. Bërja e një numri pyetjesh të thjeshta shpesh është e mjaftueshme, megjithëse në disa raste ky informacion mund të mos bëhet i dukshëm derisa fëmija të dokumentohet. Qëllimi i mbledhjes së këtij informacioni është të lejojë punonjës të rastit të vendosë se cilët fëmijë kanë një shans të lartë për ribashkim të shpejtë ose nivel të lartë të cënueshmërisë.

Menaxhimi i rasteve të mbrojtjes së fëmijëve dhe procedura e interesit më të lartë në mjediset e refugjatëve¹⁰

- Menaxhimi i rastit të mbrojtjes së fëmijëve është “një mënyrë e organizimit dhe kryerjes së punës për të trajtuar nevojat e një fëmije individual (dhe të familjes së tij) në një mënyrë të përshtatshme, sistematike dhe në kohë, nëpërmjet mbështetjes së drejtpërdrejtë dhe/ose referimeve”. Procedura e interesit më të lartë është korniza për menaxhimin e rasteve për mbrojtjen e fëmijëve.
- Menaxhimi i rastit të mbrojtjes së refugjatëve është një pjesë integrale e veprimeve të UNHCR-së në mbarë botën dhe mbulon regjistrimin, përcaktimin e statusit të refugjatit, identifikimin e zgjidhjeve të qëndrueshme ose ndjekjen e shqetësimeve të mbrojtjes të ngritura nga refugjatët. Në mjediset e refugjatëve, procedura e interesit më të lartë do të jetë gjithmonë një pjesë integrale e procesit më të gjerë të menaxhimit të rastit të refugjatëve.
- Zbatimi i procedurës së interesit më të lartë nuk është një aktivitet më vete. Në vend të kësaj, duhet parë dhe zbatuar si pjesë e një programi më të gjerë të mbrojtjes së fëmijëve që përfaqëson një qasje gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, neglizhenca, shfrytëzimi dhe dhuna, si dhe sigurimin e qasjes jodiskriminuese në shërbime dhe zgjidhje.
- Zbatimi i procedurës së interesit më të lartë duhet të bazohet në shërbime të koordinuara dhe gjithëpërfshirëse për fëmijët në rrezik. Kjo do të thotë marrjen e një qasjeje shumë-sektoriale dhe me shumë aktorë ndaj programimit të mbrojtjes së fëmijëve, ku procedura e interesit më të lartë është një komponent i një strategjie më të madhe për mbrojtjen e fëmijëve.

Zgjidhjet e qëndrueshme janë ato që sigurojnë që fëmijët e pashoqëruar ose të ndarë të jenë në gjendje të rriten në vendin e tyre të origjinës ose vendbanimit të zakonshëm, në vendin pritës ose në një vend të tretë, në një mjedis që plotëson nevojat dhe përmbush të drejtat e tyre, siç përcaktohet nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe nuk i vë fëmijët në rrezik përndjekjeje ose dëmtimi serioz.

Zgjidhjet nuk duhet të supozojnë se mosha është i vetmi faktor rreziku në rastin e një fëmije migrant pa mbrojtje. Thjesht lejimi i një fëmije të qëndrojë në një shtet derisa ai/ajo të mbushë 18 vjeç, potencialisht sepse ai/ajo nuk ka pasaportë për të konfirmuar shtetësinë e tij/saj ose sepse shteti nuk ka mundur të gjurmojë familjen ose kujdestarin e mëparshëm, nuk është një zgjidhje kuptimplote qoftë për shtetin qoftë për fëmijën. Kjo mund të çojë që fëmija të përjetojë ndalim të zgjatur dhe/ose të jetë i pastrehë, të zhduket ose të jetë i cënueshëm ndaj rrjeteve të trafikimit kur ai/ajo të mbushë 18 vjeç, si dhe nuk ka më të drejtë për mbështetje dhe strehim ose leje për të qëndruar në shtetin pritës si fëmijë. Për më tepër, shtetet nuk duhet t'i shtyjnë vendimet mbi të drejtën e fëmijëve për mbrojtje ndërkombëtare ose përfundimet në procesin BID derisa fëmijët e pashoqëruar ose të ndarë të bëhen të rritur. Çdo vonesë që nuk është e nevojshme nga rrethanat individuale të një fëmije të pashoqëruar ose të ndarë ka të ngjarë të përkeqësojë ankthin e fëmijës për të ardhmen e tij/saj dhe, për pasojë, mund të çojë në dëmtim psikologjik dhe emocional.

¹⁰UNCHR (2018). GUIDELINES ON ASSESSING AND DETERMINING THE BEST INTERESTS OF THE CHILD

Menaxhimi i rasteve është një mjet kyç në punën për mbrojtjen e fëmijëve. Ai siguron kuadrin për vlerësimin, planifikimin dhe menaxhimin e nevojave për mbrojtje të fëmijëve në rrezik në një mënyrë të strukturuar dhe sistematike. Jo të gjithë fëmijët do të kenë nevojë për ndjekje individuale dhe menaxhim të rastit. Megjithatë, ndërhyrjet e menjëhershme dhe afatgjata për fëmijët e identifikuar në rrezik kërkojnë një sistem vendimmarrjeje që mbështetet nga llogaridhënia dhe konsiderata e interesave më të larta të fëmijës.

Procesi i menaxhimit të rastit kërkon që një punonjës i rastit të identifikojë dhe, rast pas rasti, të ndërmarrë veprime për çështjet që prekin një fëmijë ose familje. Menaxhimi i rasteve në mënyrë të strukturuar është një funksion qendror i çdo sistemi të mbrojtjes së fëmijëve ose të mirëqenies sociale, qoftë në mjedise emergjente apo jo emergjente, duke përfshirë strukturat qeveritare dhe joqeveritare.

Gjurmimi i anëtarëve të familjes dhe ribashkimi i fëmijëve të pashoqëruar, të ndarë, mund të jetë një proces i gjatë dhe kompleks, shpesh duke përfshirë një numër aktorësh. Në të njëjtën kohë, mund të jetë e nevojshme të trajtohen çështjet e mbrojtjes, përveç aktiviteteve të identifikimit, dokumentimit, gjurmimit dhe ribashkimit për atë fëmijë, duke përfshirë sigurimin dhe monitorimin e kujdesit të duhur, mbështetjes shëndetësore ose psiko-sociale. Menaxhimi i rastit mundëson që të gjitha ndërhyrjet dhe informacionet që lidhen me identifikimin, dokumentacionin, gjurmimin, ribashkimin dhe mbrojtjen e një fëmije të koordinohen dhe menaxhohen pa e harruar qëllimin afatgjatë të bashkimit familjar.

1. Identifikimi i fëmijëve në rrezik dhe i fëmijëve në nevojë për vlerësim dhe mbështetje të mëtejshme

Të miturit e pashoqëruar ndonjëherë migrojnë dhe mbërrijnë pa asnjë formë dokumentacioni ose identifikimi. Një hap i rëndësishëm dhe fillestar është vlerësimi i moshës së individit. Nëse individit është më i vogël se 18 vjeç, ai/ajo klasifikohet si i mitur dhe do t'i ofrohet mbrojtje duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës. Nëse i mituri ka dokumentacion që përcakton moshën e tij/saj, ai mund të përdoret, por vetëm nëse dokumenti/at vlerësohen të jenë të besueshme. Për më tepër, një fëmije mund t'i kërkohej të japë moshën e tij/saj, por duhet theksuar se fëmijët, në rrethana të caktuara (për shembull, kur objektivi ose qëllimi i tyre për migrim është të kërkojnë punë), mund të jenë më pak të sigurtë për moshën e tyre. Në këto rrethana, mund të jetë në interesin më të mirë të fëmijës që:

- të ketë biseda të mëtejshme me fëmijën, në mënyrë që të sigurohet që ai/ajo është vërtet nën 18 vjeç; dhe/ose
- kryeni një vlerësim të moshës në mënyrë që të siguroheni që fëmija të jetë nën 18 vjeç. Kjo përfshin një vizitë te një mjek ose klinikë ku mund të bëhen analiza për të vlerësuar moshën e fëmijës.

Identifikimi paraprak është një procedurë ku zbulohen dhe identifikohen me shpejtësi fëmijët refugjatë/migrantë të rrezikuar nga dëmtimi i mëtejshëm, të cilët kanë nevojë për mbështetje dhe referim për vlerësime të mëtejshme me synimin për të mbrojtur interesat e tyre më të mira.

Kur fillon identifikimi paraprak?

Identifikimi paraprak fillon menjëherë me ardhjen e një grupi të ri refugjatësh/migrantësh në territorin e Shqipërisë, pra është detyrë e vazhdueshme e punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve. Mund të bëhet në pikën e kalimit kufitar, në qendrën e pritjes së refugjatëve/migrantëve, në një pikë tjetër takimi për refugjatët/migrantët, ose në vende të tjera ku gjendet fëmija.

Kush është përgjegjës për identifikimin paraprak?

Punonjësit e vijës së parë mund të kryejnë detyra të ndryshme që i sjellin në kontakt me refugjatët/migrantët. Nuk është e nevojshme që këta individë të kenë njohuri, aftësi dhe përvojë në punën me fëmijët.

Këta mund të jenë:

- Oficerët e policisë që kryejnë detyra paraprake identifikimi gjatë punës së tyre të rregullt për regjistrimin e refugjatëve/migrantëve, duke garantuar sigurinë në qendrat e pritjes dhe duke kryer detyrat e rregullta brenda mandatit të tyre;
- Staf i trajnuar për të punuar me fëmijët refugjatë/migrantë të punësuar ose të angazhuar në cilësinë e bashkëpunëtorëve ose vullnetarëve nga organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare të shoqërisë civile (OSHC) të specializuara në ofrimin e mbështetjes për fëmijët refugjatë/migrantë dhe në punën me fëmijët në përgjithësi;
- Stafi i angazhuar nga OSHC-të ndërkombëtare dhe kombëtare që ofrojnë forma të ndryshme mbështetjeje për refugjatët/migrantët (p.sh. shpërndarja e rrobave, sigurimi i ushqimit, lehtësimi i kontaktit telefonik të refugjatëve/migrantëve me familjet e tyre dhe personat e afërt, etj.);
- Profesionistët e punësuar në sistemin e mbrojtjes sociale.

Çfarë hapash paraprakë identifikimi duhet të merren?

Dy hapa kyç janë përcaktuar në identifikimin paraprak. I pari është vëzhgimi, dhe i dyti është shqyrtimi i shpejtë. Për të dy hapat janë përcaktuar procedurat e referimit që do të ndërmerren.

Hapi 1: Vëzhgimi

Hapi i parë në identifikimin paraprak është vëzhgimi i një grupi, familje ose fëmije të pashoqëruar. Qëllimi i këtij hapi është të njohë, brenda pak minutash, fëmijët që janë në rrezik më të lartë krahasuar me fëmijët e tjerë refugjatë/migrantë. Vëzhgimi i referohet procesit të vëzhgimit, mbi bazën e zonave të përcaktuara të vëzhgimit, pa kontakte verbale ose fizike me fëmijën refugjat/migrant ose personin(at) në afërsi të tij/saj gjatë vëzhgimit. Për qëllime të këtij dokumenti, vëzhgimi merr formën e një vëzhgimi të strukturuar, zonat e të cilit duhet të jenë të njohura për punonjësit e vijës së parë. Nëse ai/ajo gjen të dhëna/informacione që përputhen me disa nga fushat e përcaktuara, i regjistron ato në formën e duhur (Shtojca 1 - Formulari për zbatimin e treguesve paraprakë të identifikimit).

Hapi 2: Shqyrtimi i shpejtë

Shqyrtimi i shpejtë është hapi i dytë i identifikimit paraprak. Shqyrtimi i shpejtë është një vlerësim i ndërmarrë për të konstatuar me një nivel më të lartë sigurie nëse fëmija i përket një prej grupeve veçanërisht të cënueshme të fëmijëve refugjatë/migrantë, pra për të njohur rrezikun ndaj të cilit është i ekspozuar fëmija. Ai ndërmerret kur punonjësi i vijës së parë nuk është i sigurt, vetëm në bazë të vëzhgimit, nëse fëmija i përket një grupi veçanërisht të cënueshëm që ka nevojë për vlerësim dhe mbështetje të mëtejshme. Shqyrtimi i shpejtë kryhet duke bërë disa pyetje themelore të nevojshme për të njohur nëse fëmija është një nga kategoritë e cënueshme në rrezik. Pas shqyrtimit, punonjësi i vijës së parë regjistron fëmijën në kategorinë e cënueshme së cilës i përket fëmija sipas vlerësimit të tij/saj në formularin në Shtojcën 1 dhe ndërmerr veprime për referimin e mëtejshëm të fëmijës. Ai/ajo informon fëmijën dhe të rriturit që janë me të për procedurat dhe lehtëson kontaktin ndërmjet fëmijës dhe personave që do të punojnë më tej me të.

Nëse keni identifikuar një fëmijë, do të duhet të merrni masa të menjëhershme për të trajtuar problemet që lidhen me mbrojtjen, sigurinë ose shëndetin. Hapi i parë duhet të jetë gjithmonë vlerësimi, duke përfshirë shqetësimet urgjente të mbrojtjes dhe masat e kujdesit. Më pas mund të duhet të trajtoni shqetësimet urgjente të mbrojtjes nëpërmjet ndërhyrjes ose referimit të

menjëhershëm, duke filluar gjithashtu procesin e dokumentimit të fëmijës për gjurmimin/identifikimin e familjes. Kjo duhet të përfshijë referimin tek shërbimet ose organizatat/institucionet përkatëse.

Procesi i identifikimit mund të zbulojë gjithashtu probleme të tjera të mbrojtjes dhe rreziqe specifike të kontekstit për fëmijët. Fëmijët e pashoqëruar, të ndarë, veçanërisht refugjatët, migrantët dhe azilkërkuesit, mund të preken nga kërcënimet e mëposhtme, ndër të tjera: arrestimi, neglizhimi ose diskriminimi brenda mjedisit të tyre të kujdesit, shfrytëzimi për punë i fëmijëve, shfrytëzimi seksual, abuzimi ose dhuna, rekrutimi nga forcat e armatosura ose grupet e armatosura, rreziku i rekrutimit, i trafikuar më parë ose i rrezikuar nga trafikimi, martesë e hershme e detyruar dhe mungesa e dokumentacionit, si dhe humbja e identitetit.

Këto rreziqe janë një tregues i nevojës për vlerësim dhe ndjekje të mëtejshme. Përveç kësaj, përgjigjet e menjëhershme që mund të kërkohen përfshijnë:

Kujdes dhe mbrojtje të menjëhershme

- Largimi i një fëmije në një vend të sigurt dhe sekret, nëse është e nevojshme. Aty ku ofrohet kujdes për fëmijët e trafikuar, vendndodhja e tyre nuk duhet të bëhet kurrë publike.
- Identifikoni fëmijët që besohet se janë të trafikuar. Kjo është shumë e rëndësishme për t'u siguruar që atyre t'u sigurohet mbështetja e duhur dhe gjendja e tyre të mos përkeqësohet; fëmijët e trafikuar janë viktima të krimeve të rënda dhe nevojiten masa dhe procedura të veçanta sigurie.
- Mbronitë mbijetuarat e dhunës seksuale nga dëmtimet e mëtejshme të shkaktuara nga ndërhyrjet e papërshtatshme ose të pandjeshme dhe sigurohuni që ato të intervistohen vetëm nga ata që janë përgjegjës për të kryer intervista të tilla, duke respektuar dinjitetin dhe të drejtat e tyre.
- Organizoni ekzaminim dhe trajtim mjekësor urgjent, duke përfshirë kujdesin për shëndetin seksual dhe riprodhues miqësor ndaj fëmijëve dhe referimin tek partnerët që janë në gjendje të ofrojnë shërbime dhe mbështetje të specializuar për të mbijetuarat e dhunës seksuale.
- Mbajini fëmijët të sigurt nga dëmtimet e mëtejshme, duke përfshirë sigurimin që masat janë të duhurat për të parandaluar shfrytëzimin dhe abuzimin seksual (për shembull, duke kontrolluar dhe trajnuar kujdestarët mbi mënyrat sesi t'i mbajnë të sigurt fëmijët dhe duke pranuar se të mbijetuarit e abuzimit/dhunës seksuale kanë një shkallë të lartë rreziku për t'u keqtrajtuar përsëri)

Identifikimi i fëmijëve të ndarë dhe të pashoqëruar

Ndonjëherë identifikohen vetëm fëmijët e pashoqëruar, pasi stafi mund të besojë se për fëmijët e ndarë tradicionalisht kujdesen të afërmit e tyre dhe identifikimi i fëmijëve të ndarë prish format tradicionale të kujdesit. Megjithatë, duhet theksuar se fëmijët e ndarë mund të rrezikojnë nga trajtimi i pabarabartë me fëmijët e tjerë në familje: ata mund të jenë subjekt i abuzimit, neglizhimit, dhunës dhe/ose shfrytëzimit ose mund të dëshirojnë të ribashkohen me prindërit e tyre. Prandaj është e rëndësishme të kryhet një vlerësim i interesit më të lartë të fëmijës për të përcaktuar nëse ata kanë nevojë për menaxhim të rastit dhe referim në shërbime.

Nevojiten fushata të vazhdueshme informacioni në nivele të ndryshme për të identifikuar fëmijët e vërtetë të ndarë dhe të pashoqëruar dhe për të shmangur regjistrimin e rremë. Është thelbësore që të shpjegohen qartë kriteret që përcaktojnë se cilët fëmijë janë të pashoqëruar ose të ndarë dhe duhet të dokumentohen si të tillë. Regjistrimi i fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë mund të shihet si një mundësi për përfitime financiare ose materiale. Disa prindër mund t'i udhëzojnë qëllimisht fëmijët e tyre që të regjistrohen si fëmijë të pashoqëruar, të ndarë ose jetimë, me shpresën se do të marrin ushqim shtesë, mbështetje materiale ose do të përfitojnë nga opsionet e zhvendosjes. Programet më holistike për mbrojtjen e fëmijëve që synojnë fëmijët në rrezik më gjerësisht (në vend që të fokusohen

vetëm të fëmijët refugjatë të pashoqëruar dhe të ndarë) mund të ndihmojnë në parandalimin e rasteve të rreme të fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë.

Në përgjithësi, djemtë e pashoqëruar dhe të ndarë identifikohen më lehtë sesa vajzat. Prandaj, të dhënat për fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë duhet të analizohen me kujdes për të siguruar që, për shembull, mekanizmi i identifikimit i përdorur kap si vajzat ashtu edhe djemtë që janë të pashoqëruar ose të ndarë. Grupet specifike të fëmijëve të pashoqëruar, të ndarë, që mungojnë lehtësisht në procesin e identifikimit përfshijnë:

- Vajzat e pashoqëruara ose të ndara: ato mund të jenë “të padukshme” kur pranohen nga familja e gjerë ose një familje kujdestare (p.sh., duke ofruar shërbime shtëpiake në familje) dhe mund të mos identifikohen si të pashoqëruara ose të ndara nga komuniteti;
- Fëmijët e pashoqëruar, të ndarë nën 5 vjeç;
- I martuar me fëmijët e pashoqëruar, të ndarë;
- Fëmijët e pashoqëruar ose të ndarë në përkujdesje institucionale;
- Fëmijë refugjatë ose të zhvendosur që jetojnë dhe punojnë në rrugë (këta fëmijë zakonisht kanë prindër ose të afërm, por për një arsye ose një tjetër, nuk jetojnë me familjen e tyre);
- Fëmijë të pashoqëruar dhe të ndarë që jetojnë në komunitetet pritëse.

2. Referimi i rastit

Sipas Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 “Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës”, pika 10, punonjësit e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, punonjësit e Policisë së Shtetit apo të strukturave përgjegjëse për azilin ose refugjatët, brenda 12 orëve nga konstatimi apo njoftimi se në territorin e Republikës së Shqipërisë është paraqitur apo qëndron një fëmijë i pashoqëruar, referojnë rastin të punonjësi për mbrojtjen e fëmijës (në vijim, PMF) në territorin e të cilit është konstatuar fëmija, duke informuar zyrtarisht, në çdo rast, Agjencinë për gjeneralitetet dhe shtetësinë e fëmijës, nëse ato njihen, vendndodhjen e saktë të fëmijës, si dhe çdo të dhënë tjetër që tregon mënyrën e trajtimit e gjendjen e tij. Ata bëjnë verifikimin e menjëhershëm të moshës së fëmijës dhe, derisa moshë të përcaktohet saktësisht sipas legjislacionit në fuqi, ai konsiderohet se është fëmijë dhe trajtohet si i tillë.

- Informon fëmijën dhe personin(at) përgjegjës për fëmijën për mbështetjen e mundshme dhe organizatat/institucionet që do të kujdesen për fëmijën;
- Ofron mbështetje bazë në varësi të nevojës (ushqim, veshmbathje, higjienë, komunikim, etj.),
- Shoqëron fëmijën dhe personin përgjegjës në organizatën/institucionin që ofron mbështetje.

Sipas Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 “Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës”, pika 11, në rastin e fëmijëve pa shtetësi, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe Policia e Shtetit bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për të gjetur vendbanimin e zakonshëm të fëmijës së pashoqëruar. Për këtë kategori, si pjesë e përcaktimit të interesit më të lartë të fëmijës, do të shqyrtohen të gjitha mundësitë për dhënien e një lejeje qëndrimi mbi baza humanitare nëse nuk plotësohen kushtet e tjera.

3. Vlerësimi fillestar bazuar në interesin më të lartë të fëmijës

Vlerësimi fillestar i fëmijës është një procedurë ku konstatohen rreziqet konkrete për sigurinë dhe zhvillimin e fëmijës dhe nevojat e tij/saj për mbështetje, dhe ai/ajo referohet për vlerësim dhe mbështetje të mëtejshme. Ky është hapi i parë në të cilin vlerësohen interesat më të mira të fëmijës.

Qëllimi i vlerësimit fillestar të interesit më të lartë është të sigurohet që fëmijës t'i ofrohet mbështetja e nevojshme nga profesionistët dhe punonjësit përkatës të kujdesit, në kohën më të shkurtër të mundshme dhe në përputhje me nivelin e rrezikut dhe nevojat e fëmijës.

Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës që kryen vlerësimin fillestar:

- konstaton nivelin fillestar të rrezikut për fëmijën;
- konstaton nevojat fillestare të fëmijës për mbështetje;

PMF-ja, në territorin e të cilit ndodhet fëmija, bën vlerësimin fillestar të rastit, nëpërmjet verifikimit të gjeneraliteteve, të vendbanimit dhe të shtetësisë së tij, të gjendjes e trajtimit që po i bëhet, si dhe përgatit një raport të hollësishëm informues mbi arsyet e hyrjes dhe qëndrimit të pashoqëruar në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky raport përgatitet brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga momenti i raportimit të rastit dhe i përcillet agjencisë, duke pasqyruar edhe mendimin e fëmijës lidhur me kthimin ose jo të tij. PMF-ja ndjek hapat për caktimin që në fillim të një kujdestari ligjor për fëmijën e pashoqëruar, sipas legjislacionit në fuqi. Format i referimit të rastit dhe raportit që përgatit PMF-ja miratohet me urdhër të drejtorit të agjencisë.¹¹

Vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës fillon me fazën e identifikimit, plotësimin e dokumentacionit në momentin e parë që një fëmijë i huaj është takuar në territorin e Shqipërisë në cilësinë e refugjatit, migrantit apo aplikantit. Kjo fazë e procedurës së vlerësimit të interesit më të lartë nënkupton parandalimin e çdo forme rreziku për fëmijën dhe identifikimin më të detajuar të nevojave zhvillimore të fëmijës, si dhe përgatitjen për referim të mëtejshëm për shërbime specifike, profesionale, në afatin kohor sa më optimal pa rrezikuar në çdo kohë mirëqenien e fëmijës, si dhe kapacitetet dhe nevojat specifike të çdo fëmije individualisht.

Profesionisti që kryen vlerësimin e interesit më të lartë në fazën fillestare:

- Përcakton nivelin e rrezikut ndaj të cilit ekspozohet fëmija;
- Përcakton nevojat e sigurisë;
- Përcakton nevojat shëndetësore;
- Përcakton nevojat e zhvillimit;
- Referon më tej në shërbime të specializuara për vlerësim dhe ndihmë.

Vlerësimi dhe përcaktimi i nivelit të rrezikut për fëmijën kryhen njëkohësisht me ofrimin e ndihmës fillestare të nevojshme për fëmijën. Kjo siguron besueshmëri më të lartë dhe, më e rëndësishmja, përmbushjen në kohë të nevojave themelore dhe emocionale të fëmijës, duke reduktuar kështu efektet negative të çdo përvoje të mëparshme të dëmshme të kaluar nga fëmija. Kjo gjithashtu respekton të drejtat themelore të fëmijës.

Nevojat themelore të fëmijëve refugjatë/migrantë të përcaktuar nga UNHCR-ja janë:

- siguria dhe stabiliteti emocional,
- kujdesi individual dhe i qëndrueshëm nga të paktën një i rritur, nëse është e mundur me një formim të ngjashëm gjuhësor dhe kulturor,
- vazhdimësia e marrëdhënieve ekzistuese me të rriturit dhe fëmijët,
- vazhdimësia e lidhjeve shoqërore, arsimore dhe praktikave kulturore e fetare,
- ndihmë për kapërcimin e problemeve individuale,
- një mjedis që mundëson stabilitet dhe minimizon mundësinë e stresit të mëtejshëm, veçanërisht për të miturit e pashoqëruar,
- vazhdimësi në mbajtjen e lidhjeve komunitare dhe kulturore,
- ushqyerja e qëndrueshme.

¹¹Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës"

Në vlerësimin e rrezikut të fëmijës, duhet mbajtur parasysh se qëllimi parësor i të gjitha veprimeve është mirëqenia dhe zvogëlimi i dëmit ndaj fëmijës. Në këtë drejtim, asnjë vlerësim nuk është i mundur dhe nuk do të japë të dhënat përkatëse të dëshiruara, nëse nuk kryhet në situatën më të sigurt të mundshme për fëmijën, mundëson respektimin e të drejtave dhe përmbush nevojat themelore të fëmijës.

Fëmijët me nivel më të lartë rreziku konsiderohen:

- Fëmijët nën 14 vjeç;
- Fëmijë të pashoqëruar që janë ndarë nga prindërit/kujdestarët gjatë lëvizjes ose i kanë humbur gjatë lëvizjes;
- Fëmijët që udhëtojnë në një grup të pashoqëruar nga një i rritur përgjegjës;
- Fëmijët viktimë të torturës që kanë përjetuar ose kanë qenë dëshmitarë të ngjarjeve traumatike;
- Fëmijët viktimë të dhunës në familje ose neglizhencës;
- Fëmijët viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore;
- Fëmijët viktimë të kontrabandës me qenie njerëzore;
- Fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Vajzat;
- Fëmijët e lindur gjatë udhëtimit dhe të porsalindurit.

Fitimi i besimit dhe bashkëpunimit të fëmijës dhe ofrimi i mbështetjes urgjente nëse është e nevojshme.

Në këtë hap, PMF-ja:

- punon për të krijuar kontakte dhe për të fituar besimin bazë të fëmijës nëpërmjet sigurimit dhe zbutjes së ankthit të fëmijës. Në të njëjtën kohë, PMF-ja i jep fëmijës informacionin bazë se me kë po flet, ku është në atë moment, cilët do të jenë hapat e mëtejshëm, etj;
- punon për marrjen e pëlqimit të informuar të fëmijës për procedurën e mëtejshme, duke përcaktuar mënyrën e marrjes së pëlqimit në përputhje me moshën e fëmijës;
- kontrollon nëse plotësohen nevojat themelore të fëmijës dhe ofron mbështetjen e nevojshme urgjente nëse është e nevojshme, p.sh., ushqimi, uji, dushi, pushimi, gjumi etj.

Sipas Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës", pika 13, marrja e informacioneve nga fëmija bëhet me ndihmën e një psikologu apo të një të rrituri, që njih mirë natyrën e fëmijës apo që gëzon besimin e tij, dhe në gjuhën që ai kupton, nëpërmjet ofrimit të përkthyesit, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Agjencia njofton listën e plotë të përkthyesve dhe psikologëve, që janë në dispozicion të PMF-së në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kryerja e vlerësimit

Në këtë hap, PMF-ja vlerëson rrezikun për fëmijën dhe përcakton nivelin e rrezikut. PMF-ja ndërmerr hapat e mëposhtme:

- Vlerëson treguesit e vlerësimit të rrezikut të lartë dhe të mesëm (shiko treguesit e rrezikut, Shtojca 2).
- Interviston fëmijën dhe zbaton instrumentet dhe metodat e duhura të vlerësimit. Nëse fëmija është shumë i shqetësuar gjatë vlerësimit, vlerësimi ndërpritet dhe fëmija lejohet të pushojë. Gjatë kësaj interviste, punonjësi në terren përpiqet të marrë edhe të dhëna të tjera të nevojshme për fëmijën: të

dhëna për familjen, faktorët mbrojtës në dispozicion të fëmijës, aftësitë e tij/saj për vetëmbrojtje dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për fëmijën në fjalë.

- Informon fëmijën për gjetjet në mënyrë të kuptueshme nga fëmija dhe, së bashku me të, formulon konkluzionet e vlerësimit dhe bie dakord për aktivitetet e mëtejshme dhe prezantimin me profesionistë të tjerë që duhet të përfshihen në vlerësimin dhe mbështetjen e fëmijës.
- I jep fëmijës ndihmën e parë psikologjike.

• **Rrezik i lartë** për fëmijën konstatohet kur ekziston një probabilitet i lartë që fëmija të lëndohet rëndë, të keqtrajtohet ose të shfrytëzohet nëse ai/ajo mbetet në rrethanat aktuale pa mbrojtje urgjente. Brenda treguesve të hartuar, rreziku i lartë përcaktohet përmes dy grupeve treguesish: tregues të rrezikut të lartë për të gjithë fëmijët e moshës 0-18 vjeç dhe tregues të faktorëve të veçantë të rrezikut të lartë për fëmijët e moshës 0-14 vjeç.

• **Rreziku i mesëm** për fëmijën konstatohet kur vërehet se fëmija ka ndryshime të sjelljes që tregojnë për stres të vazhdueshëm dhe/ose ekziston mundësia e lëndimit të fëmijës ose mbrojtjes së pamjaftueshme nga prindi/kujdestari/i rrituri përgjegjës në periudhën e ardhshme. Mbrojtja e pamjaftueshme mund të përkeqësojë përvojat negative të fëmijës. Nuk ka asnjë provë që fëmija është në rrezik të menjëhershëm të lëndimit ose vdekjes. Ekziston shqetësimi për mundësinë e një dëmi më të madh që mund t'i shkaktohet fëmijës nëse nuk merren masa mbrojtëse.

• **Rrezik i ulët** konsiderohet kur fëmija shfaq sjellje të adaptueshme ndaj rreziqeve të migrimit dhe udhëtimit të gjatë. Ka sjellje mbrojtëse nga ana e prindit/kujdestarit/të rriturit përgjegjës. Nuk ka asnjë shqetësim për mundësinë e dëmtimit më të madh të fëmijës gjatë udhëtimit në vazhdim.

Vlerësimi i thelluar

Vlerësimi i thelluar është një vlerësim ku mblidhen informacione mbi aspekte të ndryshme të interesit më të lartë, së bashku me një vlerësim më të thellë të rrezikut nëse është e nevojshme pas vlerësimit fillestar.

Vlerësimi i thelluar është një procedurë më komplekse, e përbërë nga aktivitete të ndryshme vlerësimi që mund të trajtojnë aspekte të ndryshme të situatës së fëmijës (shëndeti, personaliteti, qëndrueshmëria, etj.). Vlerësimi i thelluar është një aktivitet që kryhet në bazë të vendimeve të PMF-së. Vendimi për të kryer një vlerësim të thelluar mund të merret nga një profesionist në mënyrë të pavarur ose me marrëveshje të arritur brenda një ekipi të formuar për fëmijën në fjalë. Në raste të caktuara, vlerësimi i thelluar mund të kryhet nga profesionistë të ndryshëm. Për të marrë vendime të vlefshme në bazë të vlerësimit të thelluar, është e nevojshme të mblidhen të dhëna nga të gjithë profesionistët e përfshirë në vlerësim. Përfundimet dhe mendimet e të gjithë pjesëmarrësve në vlerësim përbëjnë bazën mbi të cilën shqyrtohet rasti gjatë një takimi të ekipit, dhe vendimeve të marra për fëmijën.

Vlerësimi i interesit më të lartë në kontekstin e migrimit kërkon përshtatjen e kriterëve për vlerësimin e dëmit ndaj fëmijës, për të marrë parasysh pasojat specifike të migrimit për sigurinë e fëmijës. Me qëllim të përmirësimit të vlerësimit të interesit më të lartë, treguesit e paraqitur më poshtë janë përcaktuar dhe janë të detyrueshëm për PMF-në. Ata mund të përdoren edhe nga profesionistë të tjerë.

Treguesit për vlerësimin e abuzimit dhe neglizhimit (Shtojca 3)

Këta tregues janë të organizuar në tetë fusha vlerësimi. Këta janë faktorët e abuzimit dhe neglizhencës së fëmijëve që aplikohen në mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe neglizhenca në Shqipëri. Ata janë më gjithëpërfshirës dhe më të thelluar se treguesit e mësipërm të rrezikut dhe paraqiten sipas llojeve të neglizhimeve dhe abuzimeve. Struktura e treguesve është përshtatur me kushtet e refugjatëve/migracionit. Pra, ata përfshijnë tregues të rrezikut të vështirësive të trafikimit të qenieve

njerëzore në udhëtim dhe, si grup i veçantë, fushën e çrregullimeve të sjelljes dhe vështirësive mendore që mund të jenë sinjal abuzimi ose neglizhimi.

Treguesit për vlerësimin e qëndrueshmërisë së fëmijëve

Treguesit e qëndrueshmërisë së fëmijës janë të organizuar në shtatë fusha vlerësimi (Shtojca 4). Ata bazohen në konceptin teorik të një qasjeje pozitive ndaj fëmijës, në të cilën mirëqenia e fëmijës dhe orientimi ndaj forcave/qëndrueshmërisë së tij/saj personale për të kapërcyer vështirësitë është një nga postulatet bazë të qasjes. Këta tregues nuk përcaktohen në terma të moshës, por duhet të interpretohen në lidhje me moshën e çdo fëmije të caktuar. Prandaj, njohja e mirë e kapaciteteve zhvillimore të fëmijës, duke marrë parasysh moshën, është e nevojshme për zbatimin e tyre.

Treguesit për vlerësimin e qëndrimit mbrojtës të kujdestarit kryesor

Këta tregues ndahen në 11 fusha vlerësimi që kanë të bëjnë me aspektet kyçe të prindërimit mbështetës dhe mundësojnë mbrojtjen e fëmijëve në situata rreziku (Shtojca 5). Ata bazohen në një qasje pozitive dhe teoritë e prindërimit, si dhe në konceptin e elasticitetit. Në një situatë refugjati/emigrimi, prania e këtyre treguesve në marrëdhëniet e prindërve me fëmijën mund të zvogëlojë rreziqet për fëmijën gjatë udhëtimit.

Vlerësimi i Interesit më të Lartë (BIA)¹²

Puna individuale me fëmijët në rrezik, duke përfshirë fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë, duhet të bazohet në një vlerësim të nevojave për mbrojtje, me rekomandime për ndërhyrje dhe referime. Mjeti i vlerësimit i UNHCR-së për mbrojtjen e fëmijëve individualë quhet Vlerësimi i Interesit më të Lartë (BIA). Një BIA është thelbësor përpara se të ndërmerret çdo veprim që prek një fëmijë, përveç nëse kërkohet një BID. Si i tillë, një BIA duhet të jetë vlerësimi standard ose i paracaktuar i UNHCR-së për mbrojtjen e fëmijëve. Agjencitë e tjera për mbrojtjen e fëmijëve mund t'i referohen këtij procesi ndryshe, p.sh., "Një vlerësim për mbrojtjen e fëmijëve". Në përgjithësi, një BIA duhet parë si një element thelbësor i menaxhimit të rasteve dhe punës së përgjithshme për mbrojtjen e fëmijëve. Ai mbështet aktorët e mbrojtjes së fëmijëve në çdo vendim apo veprim të marrë në emër të një fëmije në përputhje me nenin 3 të KDF-së.

Një vlerësim i interesit më të lartë duhet të kryhet sapo të identifikohet një fëmijë në rrezik. Identifikimi i një fëmije në rrezik mund të ndodhë në momentin e mbërritjes, por më shpesh ndodh gjatë zhvendosjes përmes UNHCR-së ose partnerëve, ose përmes mekanizmave mbrojtës të bazuar në komunitet. Ndonëse një BIA nuk kërkon garancitë e rrepta procedurale të një BID-i, stafi me ekspertizën, aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për mbrojtjen e fëmijëve duhet të kryejë një BIA. Një BIA përfshin intervista me fëmijën dhe kujdestarët e tij/saj dhe në shumicën e rasteve përfshin edhe vizita në shtëpi. Pikëpamjet dhe dëshirat e fëmijës duhet të merren parasysh. Vlerësimi dhe rekomandimet duhet të dokumentohen për të lehtësuar monitorimin dhe ndjekjen e fëmijës dhe të gjitha ndërhyrjet.

Modeli i formularit BIA të UNHCR-së mund të përdoret për këtë ose forma të tjera të menaxhimit të rastit. Një BIA përgjithësisht rezulton me një vlerësim të situatës së fëmijës dhe rekomandime për mbrojtjen dhe ndërhyrjet e kujdesit. BIA mund të rezultojë me një rekomandim që kërkohet ose rekomandohet një BID. Edhe nëse është e qartë se do të kërkohet një BID i plotë, por do të mbahet në pritje, për shembull, për të lënë kohë për gjurmimin e familjes, një BIA mund të jetë hapi i parë.

¹²UNCHR (2018). GUIDELINES ON ASSESSING AND DETERMINING THE BEST INTERESTS OF THE CHILD

Në raste të tilla, një BIA e bërë mirë është një bazë e mirë për BID-in e plotë dhe një mjet për monitorimin e progresit në situatën e fëmijës.

Si përfundim, një BIA kërkohet përpara se të ndërmerret çdo veprim që prek një fëmijë, me përjashtim të situatave kur kërkohet një BID i plotë. Për shembull, një BIA duhet të ndërmerret në situatat e mëposhtme (por nuk kufizohet me këto situata):

- Si një vlerësim i mbrojtjes për fëmijët në rrezik (p.sh., fëmijë i nënshtruar dhunës seksuale, fëmijë në punë të rrezikshme, etj.).
- Përpara vendosjes së një fëmije në përkujdesje alternative, p.sh., një familje kujdestare.
- Para gjurmimit të familjes.
- Përpara bashkimit familjar (në disa situata kërkohet një BID).
- Masat për të trajtuar një situatë ku një fëmijë i mohohet qasja në arsim nga kujdestari i tij/saj.
- Kur një fëmijë konsiderohet për një zgjidhje të qëndrueshme vetëm me një prind.

Në kontekstin e zgjidhjeve të qëndrueshme, një BIA është i nevojshëm kur një fëmijë është duke u konsideruar për rivendosje me vetëm një prind. Në këto raste, rezultati i vlerësimit të interesit më të mirë duhet gjithashtu të shoqërojë dorëzimin e zhvendosjes. Procesi BIA siguron që interesat më të mira të fëmijës janë marrë parasysh përpara zhvendosjes.

BIA është një mjet për mbrojtjen e fëmijëve, për menaxhimin dhe zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara që janë në interesin më të lartë të fëmijëve në rrezik. Ai siguron që nevojat individuale të fëmijës dhe të kujdestarëve të tij të plotësohen përmes një procesi sistematik dhe të koordinuar. Qëllimi i BIA-s është të vlerësojë rastet individuale, të planifikojë dhe të ndërhyjë në mënyrë që të ofrojë kujdes, si dhe mbrojtje në mënyrë të qëndrueshme dhe të strukturuar për fëmijën. Në mënyrë të ngjashme, një BIA i mirëmenaxhuar gjithashtu siguron që cilësia e ndërhyrjes të jetë e qëndrueshme në të gjitha rastet. Për ta arritur këtë, BIA kërkon udhëheqje të fortë, punë në ekip dhe koordinim të mirë. Ai gjithashtu kërkon dokumentimin e të gjitha aspekteve të çështjes në një dosje fizike dhe/ose elektronike.

Jo të gjithë fëmijët kanë nevojë për ndjekje individuale dhe menaxhim të rastit. Por për ata fëmijë të identifikuar si në rrezik ose në nevojë për ndihmë, një sistem vendimmarrjeje me përgjegjshmëri siguron që të gjithë aktorët të merren parasysh dhe të angazhohen në gjetjen e ndërhyrjeve dhe zgjidhjeve të menjëhershme dhe afatgjata.

Rezultati i BIA-s është një vlerësim i detajuar i situatës së mbrojtjes së fëmijës (si dhe fuqive dhe kapaciteteve të tij/saj dhe të familjes) dhe një sërë rekomandimesh për ndërhyrjet e duhura të mbrojtjes dhe kujdesit. Megjithatë, BIA mund të rezultojë gjithashtu me një rekomandim që kërkohet ose rekomandohet një BID. Edhe nëse është e qartë se do të kërkohet një BID i plotë në hapat e mëvonshëm, për shembull, për të lënë kohë për gjurmimin e familjes, një BIA mund të jetë hapi i parë. Në raste të tilla, një BIA i bërë mirë është një bazë e mirë për BID-in e plotë dhe një mjet për monitorimin e progresit në situatën e fëmijës.

BID

Përcaktimi i interesit më të mirë (BID) përshkruan procesin formal me masa mbrojtëse procedurale të rrepta, të krijuara për të përcaktuar interesat më të mira të fëmijës për vendime veçanërisht të rëndësishme që e prekin atë. Ai duhet të lehtësojë pjesëmarrjen adekuate të fëmijëve dhe të përfshijë vendimmarrësit me fusha përkatëse të ekspertizës, të cilët mund të identifikojnë dhe balancojnë të gjithë faktorët përkatës për të vlerësuar opsionin më të mirë. Procesi duhet të dokumentohet. UNHCR-ja e përdor këtë procedurë për vendime veçanërisht të rëndësishme që prekin fëmijën, të cilat

kërkojnë masa mbrojtëse procedurale më të rrepta për të identifikuar interesat e tij/saj më të larta. Pse BID është një mbrojtje e rëndësishme për fëmijët, familjet/kujdestarët dhe komunitetet e tyre?

- Ai siguron një proces formal me masa mbrojtëse për marrjen e vendimeve që ka të ngjarë të kenë një ndikim thelbësor në jetën e fëmijëve.
- Siguron që pikëpamjeve dhe opinioneve të fëmijëve t'u jepet pesha e duhur sipas moshës, pjekurisë dhe aftësive të tyre në zhvillim.
- Ofron një vlerësim më gjithëpërfshirës të fëmijëve në rrezik që trajton spektrin e plotë të situatës, nevojave dhe dobësive të fëmijës, si dhe merr parasysh ndikimet afatshkurtra dhe afatgjata.
- Lehtëson menaxhimin e rasteve nëpërmjet zhvillimit të një plani kujdesi me monitorim më të mirë të fëmijëve në rrezik.
- Lehtëson kujdesin më cilësor për fëmijët në rrezik pasi përfshin persona me ekspertizë të ndryshme në mbrojtjen e fëmijëve.

Si një ndërmarrje e përbashkët shërben gjithashtu për caktimin e roleve dhe përgjegjësive dhe në këtë mënyrë rrit përgjegjshmërinë e aktorëve të ndryshëm të përfshirë në mbrojtjen e fëmijëve.

Udhëzimet e BID-it tregojnë qartë se kur kërkohet një BID. Situatat e mëposhtme kërkojnë që UNHCR-ja dhe/ose partnerët të ndërmarrin një BID për veprimet që prekin fëmijët që janë nën kompetencën e tyre:

- Rregullime të përkohshme të kujdesit për fëmijët e pashoqëruar ose të ndarë në situata të jashtëzakonshme në rastet e (mundshme) të ekspozimit ndaj abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit ose dhunës brenda një familjeje kujdestare ose një marrëveshje tjetër përkujdesjeje. Në rastet kur marrëveshja e kujdesit nuk është e përshtatshme për fëmijën, p.sh., në lidhje me dallimet në përkatësinë kulturore ose etnike.
- Identifikimi i zgjidhjeve të qëndrueshme për fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë: riatdhesimi vullnetar; integrimi ose zhvendosja vendore.
- Ndarja e mundshme e një fëmije nga prindërit e tij/saj (ose personi që mban të drejtën e kujdestarisë) kundër vullnetit të tyre nëse autoritetet kompetente nuk janë në gjendje ose nuk dëshirojnë të marrin veprim. Në rastet e ekspozimit (të mundshme) ndaj abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit ose dhunës brenda familjes.
- Identifikimi i zgjidhjeve të qëndrueshme ose vendimeve për marrëveshjet e kujdesit, në rastet kur situata e kujdestarisë mbetet e pazgjidhur dhe autoritetet kombëtare nuk dëshirojnë ose nuk janë në gjendje të gjykojnë për kujdestarinë. Në rastet e divorcit/ndarjes së prindërve – dhe prindërit nuk pajtohen se me cilin prind duhet të qëndrojë fëmija.
E RËNDËSISHME: Vendimet e UNHCR-së në rastet e mësipërme janë të kufizuara në përcaktimin e interesit më të lartë për fëmijën. BID nuk është një përcaktim ligjor i kujdestarisë.
- Në raste komplekse, para bashkimit familjar.
Një BID mund të ndërmerret edhe nëse nuk kërkohet zyrtarisht dhe, në një situatë kur një BIA konsiderohet e pamjaftueshme, një BID mund të ndërmerret edhe si një mjet efektiv për mbrojtjen e fëmijëve, për shembull:
- Kur vendime ose veprime të caktuara mund të kenë një ndikim të rëndësishëm dhe afatgjatë në jetën e një fëmije;
- Kur një prind ose kujdestar i një vajze ose djali nuk është në gjendje ose nuk dëshiron të përmbushë interesat më të mira të fëmijës;
- Në rastet komplekse të mbrojtjes, për shembull, nëse ka faktorë dhe të drejta konfliktuale që ndërlikojnë vlerësimin e interesave më të mira të fëmijës;
- Në situatat në lidhje me familjet poligame, pasi shumica e vendeve të zhvendosjes pranojnë vetëm një bashkëshort, duke pasur parasysh legjisllacionin e tyre kombëtar që ndalon poligaminë. Për të shmangur ndarjen e fëmijëve nga njëri prind, mund të ndërmerret një BID për të mbrojtur të drejtën e fëmijëve për të qëndruar me të dy prindërit.

Në përgjithësi, një BID duhet të kryhet për fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se dy vjet pas identifikimit të një fëmije. Është e rëndësishme të theksohet se kjo nuk do të thotë se fëmija mbetet pa mbrojtje dhe asistencë në pritje të përfundimit të BID-it të plotë. Fëmijët në rrezik kanë nevojë për BID sa më shpejt të jetë e mundur dhe kërkojnë monitorim dhe ndjekje të rregullt për të siguruar mbrojtjen dhe kujdesin e tyre. Mund të ketë situata, veçanërisht të fëmijëve shumë të vegjël, për të cilët një afat kohor dyvjeçar është shumë i gjatë, si në rastin e rregullimeve të kujdesit, ndarjes nga prindërit ose çështjeve të tjera komplekse të mbrojtjes së fëmijëve. Një qasje rast pas rasti për fëmijët që kërkojnë BID dhe ndjekje është thelbësore.

Gjithashtu, një BID nuk duhet të vendoset në pritje derisa të shfaqen perspektivat për një zgjidhje të qëndrueshme. Për shkak se rezultati i gjurmimit të familjes është një faktor kyç në përcaktimin e zgjidhjes më të përshtatshme të qëndrueshme për fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë, duhet të lihet një kohë e arsyeshme për gjurmimin. Gjurmimi i familjes duhet të fillojë menjëherë pasi fëmija të jetë identifikuar si i pashoqëruar ose i ndarë. Kohëzgjatja e arsyeshme për gjurmimin do të varet nga një sërë faktorësh, si moshë e fëmijës, përvoja e mëparshme gjurmuese për profile të ngjashme, urgjenca e rastit, cilësia e informacionit të disponueshëm për familjen dhe qasja në zonat e origjinës. Është thelbësore të dokumentohen të gjitha përpjekjet e gjurmimit të bëra në dosjen individuale të fëmijës.

Përcaktimi i interesit më të mirë në praktikë

BID trajton pyetjet kryesore, duke përfshirë:

- Ku është më mirë të jetojë fëmija sipas interesit më të lartë?
- Me kë është më mirë të jetojë fëmija sipas interesit më të lartë?
- Kush është më mirë të ketë përgjegjësinë prindërore dhe/ose ligjore për fëmijën në të ardhmen? • Si ndihet fëmija për opsionet e identifikuar dhe të propozuara?
- Cilat burime do të duhet të përdoren dhe cilat shërbime ofrohen për të mbështetur zgjidhjen e rekomanduar në BID?

Veprimet përgatitore dhe kushtet paraprake

Aty ku është përcaktuar se nevojitet një BID formal, duhet të krijohen disa kushte dhe të ndërmerren veprime përgatitore, të tilla si sigurimi që fëmijës:

- I jepet qasje në territorin e shtetit (si fëmijë në rrezik);
- Identifikohet si fëmijë i pashoqëruar ose i ndarë;
- Regjistrohet dhe pajisjet me çdo dokumentacion të nevojshëm;
- Referohet në shërbimet kompetente për mbrojtjen e fëmijëve;
- Ofrohet akomodim i sigurt dhe mbështetje e duhur nga shërbime të tilla (dhe jo të paraburgosur);
- Pajiset me leje qëndrimi të përkohshme;
- I caktohet një kujdestar;
- I ofrohen shërbime të përshtatshme shëndetësore dhe arsimore;
- I ofrohet ndihmë për të gjurmuar dhe vendosur kontakte me anëtarët e familjes, nëse një kontakt i tillë ka humbur dhe nëse rivendosja e kontaktit është (çmohet) në interesin më të lartë të fëmijës dhe nuk do ta rrezikojë familjen e fëmijës.

PMF-ja mban përgjegjësinë për kryerjen e procesit të vlerësimit, përcaktimin e interesit më të lartë të fëmijës, marrjen e vendimeve për modalitetet e përmbushjes së interesave më të mira dhe vazhdimin e zbatimit të aktiviteteve të vendosura. Përcaktimi i interesit më të lartë të fëmijës është një proces i vazhdueshëm që zgjat për aq kohë sa ka nevojë për angazhimin e institucionit të përkujdesjes sociale ku do të vendoset fëmija.

Karakteristikat kryesore të përcaktimit të interesit më të mirë

Rekomandohet që BID të hartohet për të marrë në konsideratë një sërë zgjidhjesh dhe për të rekomanduar atë që ka ndikimin më pozitiv tek fëmija në fjalë, në dritën e konsideratave përkatëse ligjore dhe të tjera. Më tej rekomandohet që BID:

- Të jetë holistik, të shikojë të gjitha rrethanat dhe të sigurojë që të krijohet një pamje e rrethanave të përgjithshme të fëmijës, duke përfshirë atë që dihet dhe nuk dihet, si dhe çfarë kërkohet për të eksploruar “opsionet” dhe për të identifikuar rezultatet e mundshme;
- Të jetë multidisiplinar (pjesëmarrësit duhet të kenë ekspertizë përkatëse dhe të jenë të aftë të identifikojnë dhe balancojnë të gjithë faktorët përkatës në mënyrë që të rekomandojnë opsionin optimal për fëmijën. Një përvojë dhe njohuri e tillë janë thelbësore, pasi pjesëmarrësve të BID-it do t'u kërkohet të parashikojnë rezultatet dhe pasojat. Ata mund ta bëjnë këtë me saktësi vetëm nëse kanë të gjithë informacionin e kërkuar);
- Të sigurojë pjesëmarrjen e fëmijëve nëpërmjet procedurave miqësore për ta, informacionit dhe mbështetjes së duhur si nga kujdestari, ashtu edhe nga përfaqësuesi ligjor ose këshilltari i fëmijës;
- Të jenë i informuar për Konventën për të Drejtat e Fëmijës, d.m.th., të shqyrtohet në dritën e një regjimi specifik mbrojtjeje/emigrimi, por gjithashtu të shqyrtojë në përgjithësi të drejtat sipas Konventës;
- Në mënyrë ideale, të përfshihet në një proces përcaktimi që është i pavarur dhe i ka të gjitha masat e duhura mbrojtëse të procesit;
- Të demonstrojë dhe dokumentojë se interesat më të mira të fëmijës kanë qenë konsiderata kryesore;
- Të jetë rigoroz, fleksibël, transparent dhe i përgjegjshëm;
- Të kryhet në kohën e duhur;
- Të marrë parasysh opsionet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

Sipas Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 “Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës”, pika 14, menaxhimi i rasteve për fëmijët e huaj të pashoqëruar, që ndodhen në Republikën e Shqipërisë, bëhet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Në çdo rast, PMF-ja, në territorin e të cilit ndodhet fëmija, merr të gjithë hapat për ofrimin e shërbimit të emergjencës dhe vendosjen e masës emergjente të mbrojtjes, më pas referon rastin në bashkinë apo njësinë administrative ku ndodhet institucioni i përkujdesjes sociale ku do të vendoset fëmija.

Kryerja e vlerësimit të fëmijës përfshin këta hapa: mbledhjen e informacionit, analizën e informacionit dhe vlerësimin e thelluar, vendimmarrjen, zhvillimin e planeve individuale, monitorimin dhe vlerësimin.

Mbledhja dhe analiza e informacionit

Mbledhja e informacionit është procesi kyç ku jepet informacioni përkatës për përcaktimin e interesit më të lartë. Në këtë pjesë të vendimmarrjes, përpilohet informacioni që tashmë është siguruar përmes identifikimit të fëmijëve dhe fëmijëve të cenusëm që kanë nevojë për vlerësim dhe mbështetje të mëtejshme, si dhe përmes vlerësimit fillestar të interesit më të lartë.

Analiza e informacionit të mbledhur është një pjesë thelbësore e procesit të vendimmarrjes. Analiza e procesit të informacionit fillon me ardhjen e PMF-së në vend. Bazuar në këtë analizë, PMF-ja, kur nevojitet, merr vendime për një vlerësim të thelluar të interesit më të lartë. Gjatë përcaktimit të interesit më të lartë, analiza e informacionit të mbledhur përsëritet vazhdimisht.

Plani individual

Një plan individual i rastit është një mjet dhe proces efektiv përmes të cilit zhvillohen dhe miratohen një sërë veprimesh pasuese për të trajtuar nevojat e mbrojtjes së fëmijës. Planifikimi i rastit duhet të

jetë konsultativ dhe të përfshijë fëmijën dhe, sipas rastit, familjen/kujdestarin e fëmijës. Bazuar në BIA, plani i rastit përshkruan ndërhyrjet e synuara, si vendosja në kujdesin e përkohshëm, gjurmimi, ndërmjetësimi dhe mbështetja familjare dhe referimi në shërbimet e duhura. Plani i rastit duhet të përcaktojë se cili aktor ose agjenci është përgjegjëse për çdo veprim në lidhje me nevojat e mbrojtjes së fëmijës, shërbimet e referimit për të cilat fëmija (dhe kujdestari i tij ose i saj) ka nevojë, dhe afatet kohore për zbatimin, të cilat do të lehtësojnë monitorimin. Plani i rastit duhet të tregojë se kur do të rishikohet progresi dhe nga kush. Opsionet e disponueshme për planet e rasteve varen nga angazhimi i një sërë ofruesish shërbimesh, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve.

Në bazë të analizës së informacionit të mbledhur dhe shqyrtimit të alternativave të mundshme, PMF-ja merr vendime mbështetur në interesin më të lartë të fëmijës. Vendimmarrja e interesit më të lartë kërkon një balancim të mirë të marrëdhënieve të ndërsjella të të gjithë faktorëve që ndikojnë në vendimin për interesin më të lartë të fëmijës. Kjo duhet të jetë një procedurë shumë e individualizuar, në të cilën vendimet për interesin më të lartë të fëmijës merren në përputhje me karakteristikat e fëmijës dhe situatën e tij/saj. Në një situatë refugjati/migrimi, ka disa vendime thelbësore për interesin më të lartë të fëmijës që ofrojnë bazën për proceset e mëtejshme të mbrojtjes së fëmijëve. Krahas vendimeve për interesin më të lartë, merren edhe vendime për masat, shërbimet dhe ndërhyrjet që synojnë përmbushjen e interesit më të lartë. Pikërisht nëpërmjet këtyre vendimeve individualizohet përcaktimi dhe përmbushja e interesave më të mira të fëmijës.

Sipas Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës", pika 14, plani individual për mbrojtjen e fëmijës duhet të përfshijë shqyrtimin e rrezikut për trafikimin e fëmijës ose sigurimin e regjistrimit nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin të kërkesës për azil dhe referimin përkatës tek autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët apo edhe të dy së bashku, nëse është rasti. PMF-ja, menaxheri i rastit, i dërgon agjencisë një raport të hollësishëm lidhur me rastin, ku pasqyrohet edhe mendimi i fëmijës lidhur me kthimin ose jo të tij.

Plani individual duhet të identifikojë disa synime për fëmijën, disa veprime për t'i arritur ato, personin përgjegjës për çdo veprim dhe një afat kohor. Veprimet mund të jenë ofrimi i drejtpërdrejtë i shërbimit nga një PMF ose referime tek shërbime të tjera sipas nevojave të fëmijës.¹³

Në rastin e fëmijëve të pashoqëruar azilkërkues, ata do të strehohen në Qendrën Kombëtare të Pritjes për Azilkërkues, kurse, në rastin e fëmijëve të pashoqëruar, që janë njëkohësisht edhe azilkërkues edhe viktima apo viktima të mundshme të trafikimit, ata do të vendosen në Qendrën Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit, ku do të vazhdojnë edhe procedurat e përcaktimit të statusit të refugjatit . Një plan gjithëpërfshirës për të trajtuar nevojat e fëmijës duhet të dokumentojë se si do të kontribuojnë fëmija, familja, komuniteti dhe agjenci të tjera. Ai duhet të përfshijë detaje të të gjitha veprimeve që do të zbatohen, si dhe afatet kohore për vazhdimin.

Plani mund të trajtojë:

- Gjurmimin dhe ribashkimin e familjes (sipas nevojës)
- Rregullime të përkohshme ose alternative të kujdesit për fëmijët që aktualisht nuk janë në kujdes të sigurt dhe të duhur
- Qasje në mbështetje psiko-sociale dhe shëndet mendor
- Qasje në arsim dhe aktivitete rekreative
- Ndihmë materiale
- Mbështetje jetese/ekonomike për familjet jashtëzakonisht të cenueshme
- Mbështetje, këshillim dhe udhëzim për kujdestarët aktualë ose të mundshëm

¹³Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës"

Fëmijët e pashoqëruar janë më të cenueshëm ndaj abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit. Merrni parasysh ndërhyrjet shitesë në përputhje me udhëzimet e dhëna për këto lloj dëmsh.

Agjencia, pas marrjes dijeni zyrtarisht për rastin, nëpërmjet shërbimit diplomatik të vendit të origjinës së fëmijës, vendit ku ndodhet familja e tij, vendit nga ka ardhur apo vendit ku ka vendbanimin e tij, informon autoritetet përgjegjëse të atij shteti për vendndodhjen e fëmijës dhe arsyet e hyrjes dhe qëndrimit të tij të pashoqëruar. Agjencia u kërkon autoriteteve përgjegjëse të atij shteti që, brenda një afati të arsyeshëm, të bëjnë një vlerësim të thelluar dhe të paraqesin një informacion të hollësishëm për fëmijën, veçanërisht për prindërit apo kujdestarin ligjor të fëmijës, si dhe aspektet që lidhen me sigurinë e fëmijës, integrimin në vendin e origjinës, kushtet e jetesës pas kthimit të mundshëm në vendin e origjinës, si dhe mundësitë për të ruajtur identitetin, kombësinë dhe lidhjet familjare¹⁴.

Raporti i paraqitur nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës i përcillet menjëherë autoritetit që ka njoftuar identifikimin e fëmijës, PMF-së, institucionit të kujdesjes sociale ku po qëndron fëmija i pashoqëruar, si dhe institucionit që po trajton kërkesat ligjore të paraqitura nga fëmija i pashoqëruar. Raporti i vihet në dispozicionin edhe kujdestarit ligjor që i është caktuar fëmijës për periudhën e qëndrimit në Shqipëri. Përrjashtimisht, në rastin e fëmijës së pashoqëruar që ka paraqitur kërkesë për azil, informacioni sipas pikës 16 (vlerësim i thelluar i fëmijës dhe familjes së origjinës), të këtij vendimi, kërkohet vetëm pasi ka marrë formë të prerë vendimi për mospranimin/refuzimin ose revokimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare¹⁵.

Mbrojtja dhe vlerësimi i vazhdueshëm

Zbatimi i këtyre aktiviteteve përcaktohet nga situata në terren dhe mundësia e ofrimit të shërbimeve dhe formave të nevojshme të mbështetjes. Në rastin e çdo fëmije specifik, vazhdimësia e shërbimeve dhe vlerësimit sigurohet nëpërmjet bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet palëve të interesuara të përfshira në ofrimin e mbështetjes për fëmijën.

Ribashkimi dhe riintegrimi janë procese që kërkojnë mbështetje të vazhdueshme dhe monitorim të rregullt edhe pasi të ketë ndodhur ribashkimi fizik. Ndonjëherë ribashkimi nuk është në interesin më të mirë të fëmijës dhe kujdesi alternativ duhet të kërkohet si masë e përkohshme. Një fëmijë në kujdesin alternativ është i cenueshëm ndaj abuzimit dhe duhet të vizitohet rregullisht për vlerësim të vazhdueshëm të nevojave dhe ndjekje të paktën një herë në muaj. PMF-të duhet të sigurojnë mbështetje shitesë për fëmijët në kujdesje alternative si p.sh., materiale gjumi, materiale edukative, ndërmjetësim për konfliktet prindër/kujdestar etj., asistencë, mbështetje prindërore dhe ndihmë materiale për prindërit kujdestarë ose kujdestarët.

Agjencia, pas shqyrtimit të raportit të paraqitur nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës, si dhe të raportit të dërguar nga PMF-ja përgjegjëse për menaxhimin e rastit, paraqet në formë shkresore mendimin për autoritetet përgjegjëse që po trajtojnë kërkesa të fëmijës për mundësinë e qëndrimit ose jo të tij në Shqipëri, duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës¹⁶.

¹⁴Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës"

¹⁵Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës"

¹⁶Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës"

Struktura pranë ministrisë përgjegjëse për azilin dhe refugjatët, si dhe autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, gjatë vendimmarrjes së tyre për aplikimin për azil, statusin e refugjatit apo për të përfutur të drejtën e qëndrimit në Shqipëri, mbajnë në konsideratë, për aq sa është e mundur, mendimin e paraqitur nga agjencia, si dhe informacione të tjera të marra nga autoritetet përgjegjëse të vendit të origjinës, në vijim të kërkesave të tyre, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi¹⁷.

Vendimmarrja për kthimin ose jo të fëmijës nuk mund të merret në asnjë rast pa u paraqitur më parë mendimi i arsyetuar i agjencisë. Ky mendim duhet të mbahet në konsideratë nga autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, me përjashtim të rasteve kur ka arsye të argumentuara e të përligjura që bëjnë të pamundur zbatimin e tij, ku përfshihen, por pa u kufizuar, rreziku ndaj sigurisë kombëtare apo rendit publik apo rrezikimi i jetës së fëmijës. Vendimi për kthimin ose jo të fëmijës merret brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e mendimit të arsyetuar nga agjencia¹⁸.

Nëse autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin vlerëson se fëmija i pashoqëruar duhet të kthehet, atëherë lëshon urdhrin e largimit dhe kthimit të fëmijës së pashoqëruar, i cili duhet të jetë i arsyetuar dhe në çdo rast duhet të përcaktojë afatin maksimal brenda të cilit duhet të zbatohet. Fëmija i pashoqëruar mund të bëhet subjekt i kthimit dhe largimit nga territori shqiptar, sipas përcaktimeve në ligjin për të huajt vetëm nëse i është refuzuar ose nuk i është pranuar aplikimi për azil, leje qëndrimi apo i është revokuar vendimi i statusit të refugjatit¹⁹.

Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin njofton menjëherë agjencinë dhe PMF-në që ka ndjekur zbatimin e planit individual të mbrojtjes së fëmijës për urdhrin e largimit dhe kthimit të fëmijës së pashoqëruar. PMF-ja, brenda 3 (tri) ditëve nga dita e njohjes me urdhrin e largimit dhe të kthimit të fëmijës, me ndihmën e një psikologu apo një të rrituri, informon fëmijën, në gjuhën që ai kupton, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, për urdhrin e largimit dhe kthimit të tij²⁰.

Për fëmijët e pashoqëruar merren masa mbrojtëse procedurale, duke përfshirë caktimin e një kujdestari ligjor, të cilat sigurojnë që fëmijët migrantë të kenë qasje në të njëjtat dispozita për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve si të gjithë fëmijët e tjerë në territorin e shtetit. Këto masa mbrojtëse sigurojnë që interesat më të larta të fëmijës të respektohen dhe ndihmojnë për të siguruar që fëmija të ketë stabilitetin fizik, psikologjik dhe emocional për të marrë pjesë në procesin e përcaktimit të statusit dhe interesit më të lartë. Për të siguruar që interesat më të larta të fëmijëve do të trajtohen si konsideratë parësore, fëmijëve duhet t'u sigurohet edhe një përkthyes profesionist, i trajnuar në mënyrë ideale për të interpretuar për fëmijët, një kujdestar ose një profesionist që ushtron një rol të ngjashëm, si dhe një intervistë miqësore për fëmijët. Këta hapa ndërmerren për të siguruar që fëmijët të mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të marrë pjesë, për të paraqitur një ankesë dhe apelim, siç zbatohet sipas ligjit kombëtar. Caktimi i një kujdestari ligjor është i rëndësishëm sepse duke qenë nën 18 vjeç, fëmijët në përgjithësi nuk janë ligjërish kompetentë për të marrë vendimet e tyre në lidhje me shërbimet e ofruara ose për të vlerësuar pasojat ligjore dhe praktike të proceseve në të cilat u kërkohet të marrin pjesë. Në rastin e fëmijëve migrantë që udhëtojnë me prindërit e tyre ose një kujdestar të njohur, prindi ose kujdestari duhet të njihet si kompetent për të marrë vendime të tilla në emër të fëmijës, përveç rasteve kur autoritetet përkatëse të mbrojtjes së fëmijëve kanë konstatuar se nuk është në interesin më të lartë të fëmijës dhe kanë ndërmarrë proceset e nevojshme sipas ligjit kombëtar për të hequr fëmijën nga kujdesi i prindit/kujdestarit. Në rastin e fëmijëve të pashoqëruar

¹⁷Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës"

¹⁸Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës"

¹⁹Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës"

²⁰Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës"

ose të ndarë, ose fëmijëve migrantë që janë hequr nga kujdesi i një prindi ose kujdestari, kjo garanton caktimin e një kujdestari dhe një përfaqësuesi ligjor dhe/ose të personave të tjerë që mund të mbështesin dhe sigurojnë interesin më të lartë të fëmijës sa më shpejt të jetë e mundur.

Çdo kujdestar ligjor duhet të ketë ekspertizë të mjaftueshme në fushën e kujdesit ndaj fëmijëve për të qenë në gjendje të konstatojë nëse interesat më të mira të fëmijës po mbrohen dhe nëse nevojat e tij/saj ligjore, sociale, shëndetësore, psikologjike, materiale dhe arsimore po plotësohen siç duhet. Si i tillë, një kujdestar duhet të ketë trajnimin dhe përvojën e nevojshme në mbrojtjen e fëmijëve dhe mirëqenien e fëmijëve, dhe, në mënyrë ideale, njohuri specifike të ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut në lidhje me fëmijët e pashoqëruar ose të ndarë.

Roli dhe detyrat e mundshme të kujdestarëve ligjorë

Kujdestarët e fëmijëve duhet t'i ndihmojnë fëmijët të marrin pjesë në procesin e interesit më të lartë. Ata duhet të veprojnë në interesin më të lartë të fëmijës dhe të luajnë një sërë rolesh gjatë gjithë procesit, për shembull:

- Të mbështesin dhe këshillojnë fëmijën bazuar në një marrëdhënie besimi;
- Lehtësimi i pjesëmarrjes së fëmijës;
- Monitorimi dhe koordinimi i ndërveprimit të fëmijës me profesionistë të tjerë;
- Përdorimi i ekspertizës së tyre për të këshilluar profesionistë të tjerë të përfshirë me fëmijën;
- Sigurimi i plotësimin të nevojave shëndetësore, arsimore, strehimit dhe mbështetjes së fëmijës;
- Sigurimi që fëmija të ketë përfaqësim ligjor nga profesionistë të trajnuar dhe me përvojë të përshtatshme;
- Sigurimi që fëmija të ketë qasje në procedurat për të përcaktuar nevojat e tij/saj për mbrojtje ndërkombëtare nëse dëshiron të aplikojë për të ose nëse është propozuar si rezultat i takimit të planifikimit të procesit;
- Marrja e këshillave të nevojshme të ekspertëve në emër të fëmijës;
- Këshillimi i hershëm i fëmijës për mundësinë e rivendosjes së kontakteve familjare nëpërmjet gjurmimit të familjes dhe pasojave të mundshme të tij, nëse fëmija nuk është më në kontakt me familjen;
- Veprimi në emër të fëmijës në lidhje me vendimet për përcaktimin e statusit dhe BID-in;
- Ndihma e fëmijës për të apeluar ose për t'u ankuar për çdo vendim që duket të jetë i paligjshëm dhe/ose i paarsyeshëm, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara.

Fëmija i pashoqëruar, nëpërmjet kujdestarit ligjor të caktuar, ka të drejtën e ankimit administrativ dhe gjyqësor, sipas legjislacionit në fuqi. Ai përfiton ndihmë juridike falas nga shteti, nëse e kërkon një gjë të tillë, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Urdhri i largimit nuk ekzekutohet deri në përfundimin e procesit të ankimit dhe marrjen e vendimit përfundimtar, përveçse kur është përcaktuar ndryshe në ligjin për të huajt. Autoritetet përgjegjëse, bazuar në rrethanat specifike të fëmijës, si kohëzgjatja e qëndrimit, vijimi i shkollës apo çështje të tjera me karakter social apo familjar, mund të urdhërojnë zgjatjen e periudhës për realizimin e procedurës së kthimit²¹.

Nga momenti i nxjerrjes së urdhrin për largimin e fëmijës së pashoqëruar dhe kthimin e tij, autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin përgatit planin e kthimit të fëmijës brenda 3 (tri) ditëve, si dhe bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse të vendit ku do të kthehet fëmija, për të përcaktuar në mënyrë përfundimtare, si më poshtë vijon²².

- a) mënyrën e kthimit dhe rrugën më të përshtatshme për transportin e fëmijës;
- b) kohën e kthimit, ku përfshihet orari i mundshëm i nisjes nga territori i Shqipërisë dhe mbërritjes në vendin e kthimit;

²¹Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës

²²Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës"

- c) personat përgjegjës për shoqërimin e dorëzimin e fëmijës, si dhe dokumentacionin e nevojshëm që nevojitet të përgatitet për dorëzimin e tij;
- ç) pikat e kontaktit ndërmjet autoriteteve, me qëllim lehtësimin e procedurës së kthimit dhe dorëzimit të fëmijës;
- d) nevojën për marrjen e masave paraprake për të garantuar të drejtat e fëmijës, çka mund të çojë në mbajtjen e fëmijës si i ndaluar vetëm si një mjet i fundit;
- dh) mundësinë e mbulimit të shpenzimeve përkatëse të procedurës së kthimit dhe të dorëzimit.

Plani i kthimit të fëmijës përfshin, por pa u kufizuar, si më poshtë vijon²³:

- a) Rregullat për përgatitjen e kthimit të fëmijës, duke përfshirë mënyrën e transportit të tij nga vendqëndrimi deri në pikën e kalimit të kufirit;
- b) Garantimin e ushqimit dhe higjienës së fëmijës gjatë gjithë udhëtimit deri në momentin e dorëzimit tek autoritetet përgjegjëse të vendit ku do të kthehet;
- c) Personin përgjegjës për shoqërimin e fëmijës nga vendqëndrimi i tij deri në dorëzimin tek autoritetet përgjegjëse të vendit ku do të kthehet;
- ç) Detyrat dhe përgjegjësitë e personit përgjegjës për shoqërimin e fëmijës;
- d) Përgjegjësitë e të gjitha autoriteteve përgjegjëse të përfshira në procedurën e kthimit të fëmijës për të mundësuar kthimin e përshtatshëm të tij;
- dh) Mënyrën e kalimit të kufirit dhe rregullat për dorëzimin e fëmijës;
- e) Dokumentacionin e nevojshëm për kthimin e fëmijës.

Një kopje e planit të kthimit të fëmijës i dërgohet agjencisë. PMF-ja, me ndihmën e një psikologu apo një të rrituri, informon fëmijën në gjuhën që ai kupton dhe në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, për planin e kthimit të fëmijës, situatën e përgjithshme sociale, ekonomike, si dhe shërbimet që do t'i ofrohen në vendin e origjinës.

Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin njofton autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve në vendin ku fëmija do të kthehet, për planin e kthimit të fëmijës, me qëllim marrjen e masave prej tyre për të siguruar mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijës. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin merr menjëherë masat për të pajisur fëmijën me dokument identifikimi të vlefshëm, nëse fëmija nuk e disponon, si dhe me dokumentet e vlefshme të udhëtimit. Në përcaktimin e mënyrës së kthimit dhe rrugës më të përshtatshme për transportin e fëmijës mbahet në konsideratë interesi më i lartë i fëmijës dhe mundësia për të siguruar kthimin më të lehtë, të shpejtë dhe të përshtatshëm të tij, në përputhje me moshën dhe mundësinë për të përballuar pa asnjë vështirësi kthimin, duke garantuar dinjitetin, nderin dhe personalitetin e fëmijës²⁴.

Fëmija shoqërohet nga kujdestari i tij ligjor gjatë udhëtimit e deri në dorëzimin tek autoritetet përgjegjëse. Nëse kjo është e pamundur, fëmija shoqërohet nga një psikolog apo një i rritur, që njuh mirë natyrën e fëmijës apo që gëzon besimin e tij. Dorëzimi i fëmijës tek autoritetet përgjegjëse të vendit të kthimit dokumentohet rregullisht, nëpërmjet procesverbalit të dorëzimit të fëmijës, ku përshkruhet në mënyrë të detajuar ecuria e udhëtimit dhe personat përgjegjës që po marrin në dorëzim fëmijën. Procesverbali nënshkruhet në tri kopje nga personat përgjegjës që kanë marrë në dorëzim fëmijën dhe personi përgjegjës për shoqërimin e tij. Një kopje e procesverbalit i dërgohet agjencisë²⁵.

Shpenzimet për kthimin e fëmijës dhe garantimin e të drejtave deri në momentin e dorëzimit, në rast se nuk mbulohen nga vendi ku do të kthehet fëmija ose nga familja e fëmijës përballohen nga buxhetet e miratuara të institucioneve përgjegjëse. Në përputhje me parimin e reciprocitetit apo të

²³Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës"

²⁴Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës"

²⁵Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës"

marrëveshjeve ndërkombëtare të zbatueshme, të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë, mund të kërkohej rimbursimi i shpenzimeve nga vendi ku fëmija kthehet apo nga familja e tij.²⁶

Regjistrimi, dokumentacioni dhe menaxhimi i të dhënave

Pas identifikimit, bëhet regjistrimi me të dhënat kryesore të fëmijës të përpiluara dhe të regjistruara. Për shembull, emri, mosha, gjinia, emri i babait dhe nënës, si dhe adresa e fëmijës, përfshihen në të dhënat e regjistrimit. Qëllimi i regjistrimit është të regjistrojë informacione të rëndësishme, kryesisht për të ndihmuar në ruajtjen e identitetit të fëmijës. Regjistrimi pasohet nga procesi i dokumentimit. Qëllimi i dokumentacionit është të regjistrojë informacione të mëtejshme për të përmbushur nevojat specifike të fëmijës. Dokumentimi i vlerësimeve të interesit më të mirë dhe planeve individuale të kujdesit është gjithashtu i rëndësishëm. Dokumentacioni do të mundësojë, për shembull, gjurmimin, ribashkimin, zbatimin e masave të menjëhershme dhe afatgjata të mbrojtjes, ndjekjen dhe BID-in.

Dokumentacioni duhet të plotësohet sa më shpejt që të jetë e mundur pas identifikimit të fëmijës, si për të minimizuar mundësinë që fëmijët të harrojnë informacione të caktuara ashtu dhe për të siguruar ndjekjen në kohë të nevojave të identifikuar. Të gjitha informacionet përkatëse për fëmijën dhe familjen e tij ose të saj duhet të dokumentohen: adresa aktuale dhe informacioni i gjurmimit, historia e ndarjes, dëshirat e fëmijës, çështjet e identifikuar të mbrojtjes së fëmijëve dhe hapat e mëtejshëm për ndjekjen bazuar në intervistat me fëmijën, anëtarët e tjerë të familjes dhe komunitetin. Për shkak se procesi i dokumentimit është një element i rëndësishëm i menaxhimit të rastit/BID-it, këshillohet që të përdoren formularët standardë. Dokumentimi nuk është një ngjarje e vetme, por më tepër pjesë e procesit vijues që vazhdon derisa fëmija të ribashkohet me familjen ose një zgjidhje e qëndrueshme të identifikohet përmes procesit BID. Për çdo rast të një fëmije në rrezik ose një fëmije të pashoqëruar dhe të ndarë, duhet të hapet një dosje që përmban dokumentacionin (fizik, elektronik ose të dyja). Ky skedar individual duhet të përditësohet me saktësi dhe të rishikohet rregullisht, si dhe duhet të përfshijë gjurmimet e rezultateve dhe ndryshimeve në jetën e fëmijës. I gjithë personeli që ka qasje në dokumentacion duhet të respektojë parimin e konfidencialitetit, në interesin më të lartë të fëmijës. Në mënyrë ideale, pasi rasti të jetë dokumentuar, informacioni duhet të futet në një bazë të dhënash për të regjistruar dhe gjurmuar të dhënat dhe për të lehtësuar menaxhimin e rastit.

²⁶Vendimit Nr. 111, datë 6.3.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës"

Shtojca 1 - Formulari për zbatimin e treguesve paraprakë të identifikimit

Emri i Fëmijës		Moshë	
Shteti, vendi i origjinës			
Emri/Mbiemri i punonjësit të terrenit	Data	Koha	Vendi

Treguesit për identifikimin paraprak me anë të vëzhgimit të strukturuar			
1	Shëndeti i fëmijës ose i të rriturit që kujdeset për fëmijën në rrezik	7	Fëmija duket i shqetësuar, nervoz
2	Siguria fizike e fëmijës në rrezik	8	Vajza/gruaja është shtatzënë ose ka një fëmijë/të vogël
3	Nevojat bazë të fëmijës në rrezik	9	Fëmija/i rrituri që shoqëron fëmijën është me aftësi të kufizuara
4	Askush nuk kujdeset për fëmijën/fëmija është vetëm	10	Një grup më i madh bashkatdhetarësh nuk kanë kontakt të përshtatshëm me fëmijën
5	Fëmija është në një grup fëmijësh pa të rritur ose me pak të rritur	11	Fëmija kërkon ndihmë
6	Qëndrimi i një të rrituri ndaj fëmijës nuk është në përputhje me rolin mbrojtës të një të rrituri	12	Një i rritur raporton se fëmija është në rrezik

Procedurat e zbatuara		
1	Referimi për kujdes mjekësor	Të gjitha rastet me rrezik të lartë shëndetësor
2	Referim te punonjësi social në terren, punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve	Të gjithë fëmijët deri në 18 vjeç
3	Mbledhja e të dhënave shtesë me një shqyrtim të shpejtë	Të gjitha rastet vlerësohen se janë të parrezikuara

Komente të tjera nga vëzhgimi

Nënshkrimi

Treguesit që kanë të bëjnë me identifikimin paraprak bazuar në shqyrtimin e shpejtë			
1	Një fëmijë i pashoqëruar nga prindi/kujdestari/i rrituri	4	Një fëmijë i ndarë nga grupi
2	Një fëmijë i ndarë nga familja/kujdestari	5	Të gjithë fëmijët deri në 18 vjeç
3	Një fëmijë që udhëton në një grup i pashoqëruar nga një i rritur përgjegjës	6	Një fëmijë që kërkon ndihmë

Shtojca 2 - Treguesit e vlerësimit të rrezikut

Treguesit e rrezikut të lartë për fëmijët e moshës 0-18 vjeç

I	Fëmija ka tentuar vetëvrasje		
II	Shëndeti i fëmijës është në rrezik		
	1	Prindi/shoqëruesi i fëmijës ofron të dhëna për sëmundjen kronike të fëmijës, por nuk ka asnjë dokumentacion për të.	
	2	Fëmija nuk ka me vete ilaçet që thotë se duhet t'i marrë rregullisht.	
	3	Prindi/shoqëruesi refuzon trajtimin mjekësor të fëmijës.	
III	Sjellja e fëmijës devijon ndjeshëm nga sjellja e zakonshme		
	1	Fëmija ka një pamje të zbrazët ose të ngrirë.	
	2	Fëmija që duket se është në moshën shkollore i përgjigjet pyetjes me zë të mërzitshëm, monoton, duke përdorur fjalë njërrrokëshe dhe duke mos shfaqur emocione.	
	3	Loja e fëmijës dominohet nga situata dhe aktivitete të natyrës seksuale.	
	4	Fëmija tregon neveri ndaj prekjes fizike dhe kontaktit dhe tkurret prapa.	
	5	Fëmija shfaq ankth jashtëzakonisht të lartë kur fëmijët e tjerë qajnë.	
	6	Fëmija është tepër i rregullt, i pastër dhe i veshur në mënyrë jo të përshtatshme me kushtet e udhëtimit.	
	7	Sjellje ekstreme – shfaqja e tepruar e emocioneve, agresivitet i lartë ose tërheqje.	
	8	Fëmija ulet dhe ngrihet me vështirësi, shprehet se ndjen dhimbje kur ulet dhe ngrihet në këmbë.	
	9	Vajzë nën 16 vjeç që është shtatzënë.	
IV	Tek fëmija ka shenja të dukshme të lëndimeve fizike		
	1	Foshnja ka mavijosje.	
	2	Fëmija ka mavijosje të shumta në formën e gjurmëve të gishtërinjve.	
	3	Fëmija ka mavijosje në qafë, fytyrë, veshë dhe krahë.	
	4	Hematoma të dukshme në lëkurën e kokës, fytyrën dhe trupin e fëmijës.	
	5	Fëmija ka djegie të dukshme që kanë konture të qarta dhe mbajnë formën specifike të objektit me të cilin janë shkaktuar.	
	6	Fëmija ka një plagë/vragë të dukshme në formën e një pickimi.	
	7	Fëmija u jep përgjigje evazive pyetjeve që lidhen me sigurinë.	
	8	Fëmija ka lëndime/vraga lëndimesh në kokë.	

V	Fëmija thotë se ai/ajo është duke u/abuzuar
1	Fëmija specifikon se kush e ka abuzuar dhe si, kur dhe ku, ose jep përgjigje të pjesshme.
2	Fëmija konfirmon jo verbalisht se është dhunuar, por nuk jep të dhëna për ta konfirmuar këtë dhe duket i frikësuar.
VI	Prindi e trajton fëmijën e tij në mënyrë të papërshtatshme
1	Prindi/personi përgjegjës kërcënon fëmijën ose kërcënon se ai/ajo do të lëndojë anëtarët e tjerë të familjes.
2	Prindi/personi përgjegjës e izolon rreptësisht fëmijën nga fëmijët e tjerë ose merret informacion se fëmija ka qenë i izoluar edhe më parë dhe nuk ka pasur kontakte me moshatarët e tij apo me mjedisin.
3	Prindi/personi përgjegjës duket se e inkurajon fëmijën të sillet në mënyrë të papërshtatshme (e inkurajon fëmijën të përfshihet në prostitucion, lypje, vjedhje dhe sjellje agresive).
4	Prindi e injoron fëmijën dhe shfaqet i ftohtë ndaj fëmijës.
VII	Fëmija shfaq sjellje të rrezikshme
1	Fëmija merr alkool/drogë.
2	Fëmija lëndon veten ose deklaron se e bën këtë dhe/ose ka shenja për ta bërë këtë.
3	Fëmija është shpesh në shoqërinë e të rriturve të ndryshëm me të cilët ai/ajo është intime në mënyrë të papërshtatshme.
4	Shpërthimet e inatit: fëmija reagon dhunshëm pa asnjë arsye edhe ndaj pakënaqësisë minimale dhe bërtet, thyen gjërat dhe hedh lodrat.
VIII	Fëmija shfaq shenja të traumës psikologjike
1	Fëmija ka makthe, izolohet nga të tjerët dhe ka sjellje të dukshme nervoze dhe sjellje të pazakontë.
2	Fëmija flet për përvojat traumatike që ka pasur sikur t'i kenë ndodhur dikujt tjetër.
3	Fëmija flet për përvojat e humbjes së anëtarëve të familjes dhe personave të afërt.
4	Fëmija reagon ndaj ngjarjeve të zakonshme të përditshme me frikë dhe tërheqje të theksuar dhe duket se po ripërjeton atë që i ndodhi, duke u dridhur nga një tingull i papritur.
IX	Fëmija kontrollohet dhe shfrytëzohet nga një person që nuk është prindi/personi përgjegjës
1	Fëmija është duke udhëtuar me një person që nuk është anëtar i familjes dhe që sillet sikur ai/ajo është pronar i fëmijës, pa intimitet emocional.
2	Fëmija reagon me frikë dhe panik të theksuar ndaj mundësisë që mund të pengohet të largohet dhe përpiqet që të mos krijojë kontakte me një agjent.
3	Fëmija shprehet se një person tjetër e detyron të bëjë gjëra që nuk dëshiron t'i bëjë (të ofrojë shërbime seksuale, të vjedhë, të lypë etj.) si kompensim për mbrojtjen dhe ndihmën që ky person i ofron gjatë udhëtimit.
4	Fëmija shmang përgjigjen në pyetjen për marrëdhënien e tij/saj me personin me të cilin udhëton.
5	Fëmija ka me vete sende me vlerë dhe nuk di si të shpjegojë se ku i ka marr paratë për t'i blerë.
X	Grupi i pashoqëruar nga një i rritur përgjegjës, me të cilin fëmija është duke udhëtuar, nuk i ofron siguri fëmijës
1	Në grup nuk vërehet asnjë ndërlidhje ndërmjet anëtarëve.
2	Fëmija nuk mund të përshkruajë më në detaje se si janë anëtarët e grupit me të cilët ai/ajo udhëton.
3	Fëmija jep përgjigje të ngatërruara se si u bashkua me grupin.
4	Anëtarët më të rritur të grupit deklarojnë se fëmija u është bashkuar së fundmi dhe se nuk kujdesen për të.
5	Anëtarët e grupit nuk i kushtojnë vëmendje përpjekjeve të fëmijës për t'u bashkuar me një aktivitet në grup.

	5	Anëtarët e grupit duket se e largojnë fëmijën.
	6	Anëtarët e grupit nuk i ofrojnë ndihmë fëmijës kur është e nevojshme (para, mbrojtje, telefon, etj.).
XI	Arsyet e largimit nga vendi që rrisin veçanërisht rrezikun për sigurinë gjatë udhëtimit	
	1	Martesa e detyruar e një vajze.
	2	Rekrutimi i detyruar.
	3	Konfliktet e luftës.
	4	Një i rritur që ka ndihmuar në organizimin e udhëtimit ka tradhtuar besimin e fëmijës.
	5	Fëmija/i riu është analfabet, nuk di të përdorë telefonin etj.
	6	Fëmija thotë se është shitur nga familja e tij/saj ose nga një person tjetër.
	7	Djali është përzgjedhur për një lloj të veçantë shfrytëzimi seksual.
	8	Fëmija thotë se ai/ajo është rrëmbyer gjatë udhëtimit.

Treguesit e rrezikut të lartë për fëmijët e moshës 0-14 vjeç

I	Nevojat themelore të fëmijës neglizhohen	
	1	Fëmija është i çrregullt, i ndotur, me baltë, i infektuar me morra, ka zgjebe; një fëmijë i vogël ka skuqje.
	2	Fëmija është i lodhur, i dobët, i uritur, i lagur, i ngrirë ose i raskapitur nga nxehtësia.
	3	Prindi/personi përgjegjës e mbikëqyr në mënyrë jokonsistente fëmijën, është i raskapitur, shfaq shenja çorientimi dhe e harron fëmijën.
	4	Fëmija nuk merr ndihmë të përshtatshme.
	5	Vogëlushi ose foshnja qëndron shumë i qetë dhe nuk shfaq asnjë reagim.
	6	Fëmija i porsalindur është blu.
II	Sjellje e dhunshme në familje/grup që udhëtojnë së bashku	
	1	Nëna ose fëmija deklaron se nëna është duke pësuar dhunë në familje/grup.
	2	Anëtarët e familjes japin informacion për ekzistencën e sëmundjeve mendore ose varësisë në familje.
III	Prindërit japin shpjegime jokonsistente dhe të palogjikshme për lëndimet e fëmijës	
	1	Shpjegimi i dhënë nga prindi/personi përgjegjës për origjinën e lëndimit të fëmijës, padyshim që nuk korrespondon me formën dhe llojin e lëndimit/vragës ose me moshën e fëmijës.
	2	Prindërit japin shpjegime të ndryshme dhe kontradiktore për dëmtimin dhe shpjegimet nuk duken bindëse.
IV	Fëmija ka pasur përvoja traumatike gjatë udhëtimit të tij/saj	
	1	Fëmija deklaron se ai/ajo ka qenë i ekspozuar ndaj bombardimeve ose konflikteve të drejtpërdrejta të armatosura.
	2	Fëmija deklaron se mbi të është qëlluar gjatë udhëtimit.
	3	Fëmija deklaron se gjatë udhëtimit është arrestuar, ndaluar, dhunuar fizikisht dhe/ose plagosur me armë zjarri nga policia e vendeve të tjera.
	4	Fëmija deklaron se prindi/personi i tij i afërt është vrarë para fillimit ose gjatë udhëtimit.
	5	Fëmija po udhëton në kushte ekstreme klimatike dhe i ka mbijetuar një stuhie/mbytjeje anijeje dhe ka fjetur në natyrë.

Shtojca 3 - Treguesit për vlerësimin e abuzimit dhe neglizhimit

I Fëmija është i neglizhuar rëndë	
1	Fëmija është jashtëzakonisht i lodhur, i dobët, i uritur, i lagur, i ngrirë ose i rraskapitur nga nxehtësia.
2	Prindi/personi përgjegjës nuk e mbikëqyr fëmijën në masë të mjaftueshme, gjë që mund të rezultojë në një rrezik serioz për sigurinë dhe shëndetin e fëmijës.
3	Prindi/personi përgjegjës nuk vëren se fëmija ka nevojë për veshje dhe këpucë në përputhje me kushtet e motit dhe refuzon ndihmën e ofruar.
4	Fëmija vesh rroba të ndotura me fekale, urinë, fëmija mban erë, prindi/personi përgjegjës nuk reagon edhe pse ka kushte për të siguruar higjienën e fëmijës në qendrën e pritjes.
5	Fëmija deklaron se prindi/i rrituri përgjegjës nuk i ka dhënë ushqim dhe ujë të mjaftueshëm për një kohë të gjatë; fëmija detyrohet të menaxhohet vetë.
6	Fëmija shprehet se prindi/i rrituri përgjegjës nuk i kushton vëmendje në situata kur ai/ajo qan, kërkon ndihmë ose vëmendje ose është shumë i frikësuar.
7	Prindi/personi përgjegjës nuk tregon gatishmëri për t'i ofruar fëmijës ndihmat e nevojshme (syze, karrige me rrota, paterica, mjete ndihmëse për ecje, etj.) dhe nuk duket se e pranon se
8	Fëmija është i sëmurë kronik dhe prindi/personi përgjegjës nuk ka barnat e nevojshme dhe refuzon të vizitojë mjekun.
9	Fëmija është i sëmurë rëndë dhe prindi/personi përgjegjës është i sëmurë.
II Fëmija vuan abuzim fizik	
1	Fëmija është nën 9 muajsh dhe ka mavijosje.
III Fëmija ka mavijosje të shumta në formën e gjurmëve të gishtërinjve	
1	Ka mavijosje në qafën, fytyrën, veshët, pjesën e sipërme të krahëve, këmbët dhe kofshët e fëmijës.
2	Ka hematoma në lëkurën e kokës, fytyrën dhe trupin e fëmijës.
3	Fëmija ka djegie, veçanërisht në duart dhe këmbët (pjesa e poshtme) ose në pjesën e sipërme të këmbëve, në formën specifike të objektit me të cilin janë shkaktuar.
4	Fëmija ka një plagë kafshimi.
5	Fëmija ka lëndime në kokë.
6	Shpjegimi se si ka ndodhur lëndimi nuk është në përputhje me llojin e lëndimit.
7	Rrëfimi i fëmijës/prindërit për ndodhjen e lëndimit është i paqartë.
8	Tregimi i fëmijës/prindërit për origjinën e lëndimit të fundit të fëmijës ndryshon në varësi të kujt i është thënë.
9	Prindërit japin të dhëna kontradiktore se si ka ndodhur lëndimi.
10	Prindërit po përpiqen të mbrojnë personin që i ka shkaktuar lëndime fëmijës.
11	Personi përgjegjës i fëmijës nuk ka informacion se si kanë ndodhur lëndimet e fëmijës para fillimit të udhëtimit, por konfirmon se disa nga dëmtimet kanë qenë të pranishme në momentin kur ai/ajo ka filluar të kujdeset për fëmijën.
12	Personi përgjegjës për fëmijën jep shpjegime jokonsistente për origjinën e lëndimeve të fëmijës gjatë udhëtimit dhe rrëfimi se si është lënduar fëmija është i paqartë dhe në kundërshtim me natyrën e lëndimeve.
IV Fëmija vuan nga abuzimi seksual	
1	Fëmija shfaq frikë nga intimiteti fizik
2	Fëmija shfaq frikë nga prekja e organeve gjenitale.
3	Fëmija thotë se ka frikë nga dyert e mbyllura, larjet, errësira dhe disa njerëz.
4	Sjellja e fëmijës është e seksualizuar dhe e papajtueshme me moshën e fëmijës.

	5	Fëmija në moshë të vogël tregon interes të pazakontë për organet gjenitale, vizatimet me përmbajtje seksuale dhe masturbim.
	6	Fëmija shfaq sjellje të detyruar, ndërrim dhe larje të shpeshtë të të brendshmeve, larje të tepruar.
	7	Fëmija është i prirur për prostitucion dhe shthurje.
	8	Loja e fëmijës dominohet nga përmbajtje të natyrës seksuale.
	9	Fëmija ndjen dhimbje kur ulet dhe ngrihet në këmbë.
	10	Një vajzë nën 14 vjeç është shtatzënë.
V	Fëmija vuan nga abuzim emocional	
	1	Prindi/personi përgjegjës e shtyn dhe e poshtëron fëmijën.
	2	Prindi/personi përgjegjës kërcënon fëmijën me dhunë, terrorizon fëmijën dhe kërcënon se do të lëndojë fëmijën ose personat e tjerë për të cilët kujdeset fëmija.
	3	Prindi/personi përgjegjës e izolon fëmijën nga bashkëmoshatarët dhe e kufizon në mënyrë drastike lirinë e fëmijës për të komunikuar me bashkëmoshatarët dhe njerëzit e tjerë, edhe para fillimit të udhëtimit.
	4	Prindi/personi përgjegjës shkel kufijtë personalë të fëmijës.
	5	Prindi/i rrituri injoron dhe është emocionalisht i padisponueshëm për fëmijën.
	6	Prindi/personi përgjegjës duket se neglizhon nevojat arsimore, mendore dhe shëndetësore të fëmijës, jo vetëm në situatën e migrimit, por përgjithësisht në qëndrimin e tij/saj ndaj fëmijës.
VI	Sjellja e fëmijës tregon pasojat e abuzimit/neglizhencës	
	1	Fëmija merr përgjegjësinë e të rriturve dhe kujdeset për fëmijët më të vegjël dhe shpreh shumë shqetësim
	2	Fëmija nuk është në gjendje të fokusohet në një aktivitet të vetëm. Ai/ajo ndryshon vazhdimisht lodrat, fillon të vizatojë dhe më pas ndalon së vizatuari dhe kthehet në diçka tjetër.
	3	Fëmija ka një pamje bosh ose të ngrirë.
	4	Fëmija që duket se është në moshën shkollore u përgjigjet pyetjeve me një zë të mërzitshëm, monoton, duke përdorur njërokëshe dhe duke mos shfaqur emocione.
	5	Fëmija shfaq ankth jashtëzakonisht të lartë kur fëmijët e tjerë qajnë.
	6	Fëmija është shumë i rregullt, i pastër dhe tepër i veshur për kushtet e udhëtimit; mënyra e sjelljes është e përshtatshme.
	7	Merret informacioni se fëmija ka problem me përqendrimin dhe interes të reduktuar për aktivitetet në të cilat ka marrë pjesë më herët.
	8	Sjellje ekstreme: shfaqja e tepruar e emocioneve, agresivitet i lartë ose tërheqje.
	9	Fëmija ka një çrregullim të zgjatur të gjumit, enurezë.
	10	Fëmija shfaq ndryshime të papritura dhe të pashpjegueshme të humorit dhe depresion.
	11	Fëmija shfaq frikë dhe kujdes ekstrem edhe në një situatë relativisht të sigurt, gjë që ishte e dukshme edhe para fillimit të udhëtimit.
	12	Fëmija ka një çrregullim zakoni, i cili ishte i pranishëm edhe para fillimit të udhëtimit.
	13	Fëmija shfaq frikë nga prindi/personi përgjegjës, nuk dëshiron të jetë me ta ose e bën këtë me ngurrim ekstrem.
	14	Ankthi ekstrem i ndarjes.
VI	Fëmija ka vështirësi mendore dhe çrregullime të sjelljes	
	1	Fëmija ka fobi, hipokondri, veprime obsesive dhe kompulsive.
	2	Fëmija ka tentuar vetëvrasjen.
	3	Sjellja antisociale dhe delikumente është e pranishme.
	4	Anoreksia dhe bulimia janë të pranishme.
	5	Depresioni është i pranishëm.
	6	Fëmija merr alkool dhe drogë.
	7	Fëmija lëndon veten ose deklaron se e bën këtë.

	8	Fëmija është shpesh në shoqërinë e të rriturve të ndryshëm me të cilët ai/ajo shfaq sjellje intime në mënyrë të papërshtatshme.
	9	Shpërthimet e inatit: fëmija reagon dhunshëm pa asnjë arsye ose me pakënaqësi minimale dhe bërtet, thyen gjërat dhe hedh lodrat.
	10	Fëmija ka ankthe, izolohet nga të tjerët dhe ka tike të dukshme dhe sjellje të pazakontë.
	11	Fëmija flet me zë të qetë për përvojat traumatike që ka pasur, sikur t'i kenë ndodhur dikujt tjetër.
	12	Fëmija reagon ndaj ngjarjeve të zakonshme të përditshme me frikë dhe tërheqje të theksuar dhe duket se po ripërjeton atë që i ndodhi.
VIII	Fëmija ka përvoja traumatike për shkak të kushteve të udhëtimit	
	1	Fëmija shprehet se ka qenë i ekspozuar ndaj bombardimeve ose konflikteve të drejtpërdrejta të armatosura.
	2	Fëmija deklaron se mbi të është qëlluar gjatë udhëtimit.
	3	Fëmija deklaron se gjatë udhëtimit është arrestuar, ndaluar dhe/ose dhunuar fizikisht nga policia e vendeve të tjera.
	4	Fëmija deklaron se prindi/personi i tij i afërt është vlarë para fillimit ose gjatë udhëtimit.
	5	Fëmija po udhëton në kushte ekstreme klimatike dhe i ka mbijetuar një stuhie/mbytjeje anijeje.
	6	Fëmija thekson se ka detyrim ndaj familjes që të arrijë në destinacion sa më shpejt të jetë e mundur, është shumë i shqetësuar dhe nuk dëshiron të kalojë më shumë kohë sesa duhet në udhëtim.
	7	Fëmija ka dëshmuar/parë dhunë brutale, rrëmbim apo abuzim të fëmijëve.
	8	Fëmija flet me zë të qetë dhe pa reagim emocional për prindërit dhe vëllezërit e motrat e tij/saj që kanë qëndruar në vendin e origjinës.
VIII	Fëmija ndodhet në një situatë të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore	
	1	Fëmija është duke udhëtuar me një person që nuk është anëtar i familjes dhe që e trajton fëmijën sikur ai/ajo e zotëron atë, pa intimitet emocional.
	2	Fëmija shfaq frikë dhe panik të theksuar në lidhje me mundësinë e pengimit të largimit dhe pamundësisë për të vendosur kontakt me një punonjës sigurie.
	3	Fëmija deklaron se një person tjetër e detyron të bëjë gjëra që nuk dëshiron t'i bëjë (të ofrojë shërbime seksuale, të vjedhë, të lypë etj.) si kompensim për mbrojtjen dhe ndihmën që ky person i jep gjatë udhëtimit.
	4	Fëmija shmang përgjigjen në pyetjen për marrëdhënien me personin me të cilin udhëton.
	5	Fëmija ka me vete sende me vlerë, dhe nuk arrin të jap shpjegim për paratë me të cilat i ka blerë.
	6	Fëmija di fjalë që kanë të bëjnë me aktivitetet seksuale në një gjuhë tjetër.
	7	Një person tjetër kontrollon kontaktet e fëmijës me bashkëmoshatarët e tij/saj dhe njerëzit e tjerë.
	8	Një person tjetër e detyron fëmijën të punojë, mbikëqyr punën e fëmijës; puna e fëmijës është e papërshtatshme për moshën dhe aftësitë e tij/saj.
	9	Fëmija është jashtëzakonisht intim me një person që nuk është anëtar i familjes së tij/saj dhe tregon bindje ndaj këtij personi, madje më shumë se sa ndaj prindërve dhe familjes së tij/saj.
	10	Duket se një person tjetër interesohet për punën e fëmijës ose abuzon me fëmijën për qëllimet e tij/saj.
	11	Fëmija deklaron se një person tjetër po kërcënon se do ta lëndojë atë ose familjen e tij/saj, nëse fëmija nuk pranon kërkesat e atij personi.
	12	Fëmija deklaron se një person tjetër ka dokumentet e tij/saj dhe paratë e fituara.
	13	Fëmija ka një agjent që organizon udhëtimin e tij/saj.

Shtojca 4 - Treguesit e qëndrueshmërisë së fëmijëve

I	Fëmija tregon lidhje të sigurt me kujdestarin e tij/saj	
	1	Fëmija eksploron lirisht, largohet dhe kthehet në prani të kujdestarit të tij/saj.
	2	Fëmija i drejtohet lirisht dhe spontanisht kujdestarit të tij/saj dhe duket i sigurt se do të marrë një përgjigje.
	3	Fëmija kontakton lirisht me të tjerët, shikon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të relaksuar mjedisin e tij/saj dhe njerëzit e tjerë në prani të kujdestarit të tij/saj.
	4	Fëmija shpreh lirshëm ndjenjat e tij dhe tregon se pret përgjigje për to.
	5	Fëmija bën lirisht pyetje dhe kërkon atë që aktualisht është interesante për të ose çfarë i nevojitet.
	6	Fëmija duket i qetë, i kënaqur dhe i gëzuar.
	5	Fëmija kërkon kujdestarin e tij/saj kryesor në një situatë pasigurie apo rreziku dhe duket se ndihet i sigurt dhe i mbrojtur në shoqërinë e tij/saj.
II	Fëmija ka aftësi të mira komunikuese	
	1	Fëmija shfaq sjellje që është shoqërisht e hapur, bashkëpunuese dhe miqësore.
	2	Fëmija mund t'i njohë emocionet dhe nevojat e tij dhe t'i shprehë në mënyrë që palët në bisedë t'i kuptojnë ato.
	3	Fëmija është në gjendje të njohë ndjenjat dhe nevojat e palëve të tjera.
	4	Fëmija mund të tregojë ndjeshmëri për të tjerët.
	5	Fëmija mund të fokusohet "këtu dhe tani" në komunikim.
	6	Fëmija di të inkurajojë të tjerët të marrin pjesë në një bisedë.
	7	Fëmija di të bashkërendojë shprehjen verbale me atë joverbale.
	8	Fëmija shpreh qartë qëndrimin, ndjenjat, nevojat dhe pritshmëritë e tij/saj.
	9	Fëmija njeh nevojat dhe pritshmëritë e palëve të tjera dhe u përgjigjet atyre.
III	Fëmija ka aftësinë për të përballuar ndryshimin	
	1	Fëmija është në gjendje të pranojë ndryshimet dhe i percepton përvojat e reja si konstruktive, megjithëse ato mund të jenë të dhimbshme.
	2	Fëmija i percepton përvojat e reja si sfida.
	3	Fëmija ka një ndjenjë koherence – ai/ajo i percepton problemet si të kuptueshme, kuptimplote dhe të zgjidhshme.
	4	Fëmija e sheh veten të përfshirë dhe të lidhur me të tjerët.
	5	Fëmija shfaq sjellje dhe aftësi me të cilat ai/ajo mund të rregullojë reagimin e tij/saj ndaj ngjarjeve (emocionet, njohjen dhe dhimbjen e tij/saj).
	6	Fëmija përpiqet t'i përshtatë situatat me veten dhe përvojën e tij në masën e mundshme.
	7	Fëmija përpiqet të ndryshojë reagimet e tij/saj dhe të fitojë aftësi të reja në mënyrë që të jetë në gjendje të "përballojë" një situatë të re.
	8	Fëmija është i pavarur në marrjen e vendimeve për veten e tij, zbatimin e këtyre vendimeve dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të tyre.
	9	Fëmija është i aftë të ruajë shëndetin e tij mendor pavarësisht nga vështirësitë.
	10	Fëmija është i aftë të ecë përpara pavarësisht nga problemet në jetën e tij/saj.
IV	Fëmija ka aftësi të mira për zgjidhjen e problemeve	
	7	Fëmija mund të bëjë dallimin midis gjërave të rëndësishme dhe të parëndësishme në një situatë specifike dhe të identifikojë problemin.
	6	Fëmija mund të njohë dhe shprehë nevojat e tij/saj.
	6	Fëmija mund të marrë përgjigjësi.

	4	Fëmija mund të njohë alternativat që i paraqiten.
	5	Fëmija mund të zgjedhë midis alternativave që ka në dispozicion.
	6	Fëmija mund të vlerësojë ndikimin e veprimeve të ndërmarra në ngjarje të mëtejshme.
	7	Fëmija mund të mendojë i pavarur nga mendimet e të tjerëve dhe të marrë vendime praktike dhe të mira.
	8	Fëmija bën pyetje që lidhen me situatën e tij/saj.
	9	Fëmija mund të bashkëpunojë me të tjerët në procesin e zgjidhjes së problemeve.
	10	Fëmija është gjithashtu i aftë të zbatojë zgjidhjen e gjetur.
V	Fëmija ka vetëbesim pozitiv	
	1	Fëmija beson në veten e tij/saj dhe në gjykimin e tij/saj për ngjarjet dhe ndjen se mund të marrë pjesë me kompetencë.
	2	Fëmija ka një sens të brendshëm kontrolli, një perceptim se ai/ajo është i pavarur nga të tjerët.
	3	Fëmija mund të kontrollojë impulset e tij/saj.
	4	Fëmija e sheh veten si një person pozitiv me vlera njerëzore.
	5	Fëmija beson se mund të zgjidhë në mënyrë të pavarur problemet dhe të kryejë aktivitetet kryesore të mbijetesës së përditshme.
	6	Fëmija beson në rezultate pozitive të situatës pavarësisht nga rrethanat e të vështira.
VI	Fëmija ka një perceptim pozitiv për identitetin e tij/saj	
	1	Fëmija ka një vetëdije të zhvilluar mirë për veten e tij/saj.
	2	Fëmija është i aftë të lidhë perceptimin e tij/saj në të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen.
	3	Fëmija ka kufij të qartë midis tij/saj dhe familjes /grupeve të tjera të cilave u përket dhe e percepton veten si të ndarë dhe të ndryshëm nga të tjerët.
	4	Fëmija e percepton veten si unik dhe të veçantë.
	5	Fëmija e sheh veten si një person me vlerë të denjë për dashuri dhe respekt.
	6	Fëmija mund të gjejë një ekuilibër midis asaj që po ndodh dhe aftësive të tij/saj.
	7	Fëmija pranon atë pjesë të vetvetes që përcaktohet nga kultura dhe bindjet e njerëzve, zonës dhe familjes nga vjen.
	8	Fëmija është në gjendje të ruajë karakteristikat e veta themelore dhe të ndërmarrë hapa për t'u përshtatur dhe për të mbijetuar në rrethana të ndryshuara.
VII	Fëmija ka aftësinë t'i përdorë të rriturit për ndihmë dhe mbështetje	
	4	Fëmija di si të kërkojë ndihmë nga të rriturit kur e kupton se ka nevojë për ndihmë në një situatë të caktuar.
	4	Fëmija ka disa të rritur mbi të cilët mund të mbështetet dhe që janë modeli me të cilët identifikohet.

Shtojca 5 - Treguesit për vlerësimin e qëndrimit mbrojtës të kujdestarit kryesor

VIII	Prindi ka një marrëdhënie të mirë me fëmijën	
	1	Prindi e vlerëson dhe respekton vërtet fëmijën, pa asnjë manipulim dhe ndërhyrje prindërore.
	2	Prindi e përfshin fëmijën në procesin e marrjes së vendimeve në lidhje me fëmijën.
	3	Prindi di të vendosë kufijtë e duhur për fëmijën.
	4	Prindi inkurajon fëmijën të mësojë dhe të zhvillohet.
IX	Prindi ka një marrëdhënie të mirë me fëmijën	
	1	Prindi e sheh dhe e percepton pozitivisht fëmijën dhe i dërgon një mesazh të qartë fëmijës se është i admirueshëm.
X	Prindi zhvillon optimizëm prindëror	
	1	Prindi ka një tendencë relativisht të qëndrueshme, të përgjithshme dhe një qasje pozitive dhe është i vëmendshëm ndaj situatave ku ka rreze të konsiderueshme.
	2	Prindi ka shpresë se gjithçka do të jetë në rregull.
XI	Prindi zhvillon optimizëm prindëror	
	1	Prindi di të njohë nevojat e fëmijës dhe t'u përgjigjet atyre.
	2	Prindi di të harmonizojë nevojat e fëmijës me nevojat e veta.
XII	Prindi është i përgjegjshëm dhe i qëndrueshëm në kujdesin e tij/saj	
	1	Prindi shfaq vazhdimisht pozitivitet, mirësi, ngrohtësi dhe ndjeshmëri ndaj fëmijës dhe është gjithmonë emocionalisht i disponueshëm për fëmijën.
	2	Prindi vazhdimisht mbështet arsyetimin e fëmijës dhe kupton dhe percepton sjelljen e vetë fëmijës.
	3	Prindi e mbikëqyr dhe mbron në mënyrë adekuate fëmijën në/nga situata të rrezikshme.
	4	Prindi kujdeset për shëndetin, zhvillimin, edukimin dhe shoqërimin e fëmijës.
XIII	Prindi demonstroi prindërim efektiv	
	1	Prindi drejton me sukses sjelljen e fëmijës.
	2	Prindi zhvillon me sukses pavarësinë e fëmijës.
	3	Prindi zhvillon me sukses moralin dhe aftësitë sociale të fëmijës.
	4	Prindi inkurajon fëmijën që të zhvillohet në potencialin e tij/saj.
	5	Prindi e drejton fëmijën drejt arritjes dhe ndjenjës së suksesit të tij/saj.
	6	Prindi zhvillon zakonet e punës së fëmijës dhe e inkurajon të arsimohet.
XVI	Prindi dhe familja kanë të zhvilluar mirë qëndrueshmërinë	
	1	Prindi tregon iniciativë në zgjidhjen e problemeve dhe situatave të reja.
	2	Prindi dhe familja përpiqen të ripërcaktojnë atë që po ndodh në një mënyrë racionale dhe të pranueshme.
	3	Prindi pranon atë që nuk mund të ndryshojë.
	4	Prindi përpiqet të menaxhojë situatat ku ai/ajo mund të ndikojë.
	5	Prindi përpiqet të vendosë rregull, ekuilibër dhe harmoni edhe në situata jashtëzakonisht të vështira.
	6	Prindi përpiqet të kontribuojë në komunitet edhe në situata krize dhe sfidash të mëdha.
	7	Prindi përpiqet të forcojë dhe zhvillojë fuqitë pozitive të familjes edhe në situata me rrezikshmëri të lartë.
	8	Prindi dhe anëtarët e tjerë të familjes ndajnë kujdesin për fëmijën.

XV	Prindi pranon ndihmën dhe përgjegjësinë	
	1	Prindi e kupton se ai/ajo ka nevojë për ndihmë.
	2	Prindi është i gatshëm të kërkojë ndihmë kur ka nevojë dhe di ta pranojë atë.
	3	Prindi kërkon informacionin e nevojshëm për rrethanat e reja.
	4	Prindi kërkon mbështetje nga njerëzit e tjerë dhe komuniteti
		Prindi merr përgjegjësinë për vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën dhe familjen e tij/saj.
XVI	Prindi është i hapur për të diskutuar çështje të vështira	
XVII	Prindi është i aftë për vetërregullim	
	1	Prindi beson në gjykimin e tij/saj, mbështetet tek ai në kryerjen e rolit prindëror dhe është i pavarur në marrjen e vendimeve prindërore.
	2	Prindi ka njohuri dhe aftësi, si dhe është fleksibël në zhvillimin e besimit të fëmijës ndaj tij.
	3	Prindi beson se ai/ajo mund të kapërcejë problemet që dalin në drejtimin e sjelljes së fëmijës.
	4	Prindi beson në aftësitë e tij për të kryer në mënyrë të pavarur aktivitetet e nevojshme për të arritur qëllimin e tij në rritjen e fëmijës.
	5	Prindi zhvillon vetëkontroll në kryerjen e rolit prindëror.
	6	Prindi zhvillon aftësitë e zgjidhjes së problemeve dhe të kontrollit emocional.
	7	Prindi di të angazhohet për qëllimet që ai/ajo vendos në zhvillimin e fëmijës.
	8	Prindi zgjedh në mënyrë të pavarur mënyrat për të bërë ndryshime në rolin e tij prindëror.
	9	Prindi di të vlerësojë performancën e tij/saj si prind.
XVIII	Prindi ka një rol aktiv në mbështetjen e fëmijës së tij/saj	
	1	Prindi e mbështet në mënyrë aktive fëmijën e tij/saj duke i deleguar përgjegjësinë për zgjedhjet dhe veprimet e fëmijës.
	2	Prindi bisedon me fëmijën për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me fëmijën dhe së bashku me të shqyrton situatat dhe ngjarjet, duke ia deleguar fëmijës përgjegjësinë për vendimmarrje.
	3	Prindi bashkëpunon me institucione dhe organizata për t'i ofruar zhvillim dhe mbrojtje fëmijës.
	4	Prindi ka bashkëpunim të mirë me profesionistët.

Shtojca 6 - Shembull i formularit të vlerësimit të interesave më të larta (BIA)²⁷

Identifikimi dhe ndjekja e fëmijëve në rrezik	
Të dhënat biografike	
Emri i fëmijës (+ pseudonimi)	Skedari/Regjistrimi i progresit #
Data e lindjes/mosha	Rastet e lidhura
Vendi i lindjes	Fëmija i identifikuar nga (oficeri/agjencia)
Vendi i origjinës	Kombësia
Gjinia • Femër • Mashkull	
Emri i babait biologjik	Qëllimi i BIA-s
Emri i nënës biologjike	Emri i kujdestarit aktual
Adresa aktuale	
Detajet e kontaktit	
Nevoja të veçanta	
Emri i ofruesit të shërbimit/ referimit	• Përparësi e lartë • Përparësi • Normal

Emri i vlerësuesit	Data e intervistës/vizita në shtëpi
E-mail	Tel. #
Agjencia/Institucioni	Nënshkrimi
A jep fëmija (ose kujdestari nëse është e përshtatshme) pëlqimin e informuar për intervistën? • PO • JO	

I. Informacion i përgjithshëm

Përkatësia etnike	
Feja	
Gjuhët e folura	
Niveli i arsimit	

²⁷ UNCHR, 2011. Field Handbook for the Implementation of UNHCR BID Guidelines

Nëna	
Emri i nënës	
Kur e keni parë nënën tuaj për herë të fundit?	
Ku?	
Ku mendoni se është nëna juaj tani?	
A ka ajo një numër telefoni?	

Babai	
Emri i babait	
Kur e keni parë babanë tuaj për herë të fundit?	
Ku?	
Ku mendoni se është babai juaj tani?	
A ka ai një numër telefoni?	

Vëllezërit e motrat		
Emri	Mosha/Seksi	Vendndodhja aktuale

II. Historia e ndarjes

Pyetje të sugjeruara: Si u ndatë nga familja? (Tregoni kohën, vendin e ndarjes, si dhe shkaqet e ndarjes.) Pse u larguat nga vendi juaj? Si keni udhëtuar në (emri i vendit të azilit)? (Tregoni mënyrën dhe rrugën e udhëtimit, emrat e personave që kanë ndihmuar dhe marrëdhëniet e tyre me fëmijën e pashoqëruar/të ndarë); Kur keni mbërritur (emri i vendit të azilit)? A keni ndonjë të afërm apo mik në (emri i vendit të azilit)? Nëse po, jepni emrin, marrëdhënien dhe detajet e kontaktit (nëse ka). A ka ndonjë gjë tjetër që dëshironi të tregoni për udhëtimin tuaj?

III. Vlerësimi i nevojave për mbrojtje dhe kujdes

Mënyra e jetesës dhe e kujdesit

Pyetje të sugjeruara: Me kë jetoni aktualisht? (Shënoni emrat, moshat, gjininë) A ka ndonjë të rritur (emri/vendndodhja në vendin e azilit) që kujdeset për ju? Nëse po, shënoni emrin, marrëdhënien, informacionin e kontaktit. Si e gjetët këtë vend për të qëndruar? Si është marrëdhënia juaj me kujdestarin dhe/ose shokët e shtëpisë? Cilat janë aktivitetet (punët) tuaja në shtëpi? Cilat janë aktivitetet (punët) e fëmijëve të tjerë në familje? A mendoni se trajtoheni njësoj si fëmijët e tjerë? A ju pëlqen të qëndroni me këtë familje? A jeni i lumtur këtu?

Siguria

Pyetje të sugjeruara: A ndiheni të sigurt në këtë vend? Nëse jo, cilat janë arsyet/a ka ndodhur ndonjë incident (nëse po, përshkruani)? A mund të përshkruani vendin ku po qëndroni? Vini re numrin e dhomave, kushtet dhe sa njerëz jetojnë në atë vend, etj.

Shëndeti dhe qasja në kujdesin mjekësor

Pyetje të sugjeruara: A ndiheni të shëndetshëm? Nëse jo, ju lutemi shpjegoni llojin e sëmundjes/si ndiheni fizikisht. A keni qasje në kujdesin mjekësor? Nëse jo, shpjegoni pse?

Qasja në ushqim

Pyetje të sugjeruara: A merrni racione ushqimore? Nëse po, sa dhe kur? A mendoni se keni ushqim të mjaftueshëm? Nëse jo, ju lutemi shpjegoni. Çfarë keni ngrënë dje?

Uji dhe higjiena

Pyetje të sugjeruara: A keni qasje në ujë të pastër? A janë objektet e duhura të higjienës në vendin ku jetoni? A ka ndonjë rrezik për ju?

Edukimi

Pyetje të sugjeruara: A ndiqni aktualisht shkollën apo ndonjë aktivitet edukativ? Ju lutemi përshkruani (emrin e shkollës/kursin e trajnimit, notën, frekuentimin, etj). Nëse jo, shpjegoni pse jo. A keni shkuar në shkollë para ndarjes? A ju pëlqen të shkoni në shkollë? Nëse po, çfarë ju pëlqen më shumë në shkollë? Nëse jo, shpjegoni arsyet. A shkojnë në shkollë fëmijët e tjerë në shtëpi?

Aktivitetet ditore të fëmijës

Pyetje të sugjeruara: A luani me fëmijë të tjerë? Nëse po, çfarë bëni dhe ku? Sa orë në ditë? A punoni aktualisht për të fituar para? Nëse po, çfarë bëni? Sa orë në ditë? Çfarë bëni me paratë që fitoni?

Mbrojtja dhe mirëqenia psiko-sociale

Pyetje të sugjeruara: Ku shkoni për të diskutuar problemet apo për të kërkuar ndihmë? A merrni mbështetje nga komuniteti juaj? Nga kush dhe çfarë lloj mbështetjeje? Nëse jo, ju lutemi shpjegoni. A ndiheni të sigurt nga dëmtimi? Keni ndonjë shqetësim të veçantë? A flini mirë? Keni makthe? Nëse po, sa shpesh?

Gjurmimi

Pyetje të sugjeruara: Dëshironi t'ju ndihmojmë për të gjetur disa nga anëtarët e familjes suaj? Nëse po, vini re se kë do të dëshironite të gjurmonte/gjente fëmija dhe çdo informacion që ka për vendndodhjen e të afërmeve. Nëse jo, cilat janë arsyet që nuk dëshironi të gjeni prindërit tuaj? A po bëhet gjurmimi/gjetja e anëtarëve të familjes? Nëse po, nga cili institucion? A jeni informuar për rezultatet? A ka nevoja shtesë?

Të tjera

Pyetje të sugjeruara: A ka ndonjë informacion tjetër që dëshironi të ndani me mua sot?

IV. Vizitat në shtëpi

Pyetje të sugjeruara: Vini re emrin, moshën dhe gjininë e personave të pranishëm në shtëpi në kohën e vizitës. Kush jeton aktualisht me ju në këtë shtëpi? (Vini re emrat, moshat, gjininë) Sa kohë keni që jetoni këtu? Kush e përgatit ushqimin? Sa shpesh hani? Çfarë lloje/lloj ushqimesh hani? Ku flini në këtë shtëpi? Si e kaloni kohën? Çfarë ju pëlqen të bëni? Si ndiheni kur jetoni në këtë shtëpi? A jeni i lumtur këtu?


V. Informacioni i plotësuar nga vlerësuesi

Pyetje të sugjeruara: A duket fëmija i shëndetshëm? Nëse jo, shpjegoni. A ka fëmija probleme me ushqimin? A ka nevoja (urgjente) mjekësore? Nëse po, ju lutemi shpjegoni. A ka fëmija veshje të mjaftueshme? Ju lutemi, përshkruani përshtypjet për shtëpinë. A duket fëmija i frikësuar/i tërhequr/i pakënaqur (për t'u vlerësuar/plotësuar nga vlerësuesi, ju lutemi jepni detaje)? A ka nevoja (urgjente) të mbrojtjes ose rreziqe që duhen trajtuar (jep detaje)?

VI. Intervistë verifikimi me kujdestarin e të rriturve/familjen kujdestare (vetëm nëse është e zbatueshme)

Emri i kujdestarit/es	
Mosha	Gjinia
Përkatësia etnike	Marrëdhënia me fëmijën
Cili është emri i nënës së fëmijës?	Cili është emri i babait të fëmijës?
<p>Pyetje të sugjeruara: Ku jetonte fëmija më parë? (Emri i krahinës, fshatit) Si u nda fëmija nga familja e tij/saj? Çfarë informacioni keni për fëmijën dhe jetën e tij/saj? Kur e keni takuar për herë të parë fëmijën? Sa kohë ka fëmija që jeton me ju? Si erdhi fëmija të jetonte me ju? A jeni në kontakt me prindërit e fëmijës ose të afërm të tjerë? Nëse po, ju lutemi jepni informacionin e kontaktit. Si është marrëdhënia juaj me fëmijën? A jeni në gjendje të vazhdoni të kujdeseni për të? A është fëmija i shëndetshëm? A ka ndonjë informacion tjetër që dëshironi të ndani me mua sot?</p>	

VII. Vizatimi i fëmijës²⁸



²⁸ Në këtë pjesë fëmijët që janë të ndarë mund të vizatojnë një pemë familjare ose shtëpinë e tyre të mëparshme. Ata mund të tregojnë dhoma të ndryshme të shtëpisë dhe kush jeton në secilën dhomë. Vizatime të tilla ndihmojnë në nxjerrjen në pah të marrëdhënieve familjare dhe informacioneve të tjera të dobishme gjurmuese. Fëmija gjithashtu mund të vizatojë fshatin, lagjen ose qytetin e vjetër, dhe ndërtesa të rëndësishme, si shkolla ose xhamia e tyre.

VIII. Përmbledhje dhe rekomandime

Përmbledhja e rastit + nevojat e identifikuara + vëzhgimet

Veprimet/Referimi i rekomanduar	
<ul style="list-style-type: none"> • Strehë e sigurt • Përcaktimi i statusit të refugjatit • Mbrojtja • Asistencë mjekësore • Kujdesi alternativ • Mbështetje psiko-sociale • Këshillim • Ushqimi • Ujë/Higjienë • Edukimi • Strehim • Aktivitete rekreative/komunitare • Vizita të rregullta në shtëpi 	Ndihma të tjera specifike (specifikoni)
	Nevoja për BID <ul style="list-style-type: none"> • Përparësi • Normal

IX. Plani i veprimit (rendit përparësitë)

Veprimi i kërkuar	Ofruesi i shërbimit Përgjegjës	Veprimi i kryer + Data	Statusi/gjendja

Veprimi i kërkuar	Ofruesi i shërbimit Përgjegjës	Veprimi i kryer + Data	Statusi/gjendja

Data e vizitës së radhës në shtëpi	Data e rishqyrtimit të këtij rasti
Nënshkrimi i profesionistit të mbrojtjes së fëmijëve	Nënshkrimi i profesionistit të rishqyrtimit
Data	Data

Shtojca 7 - Raporti i Përcaktimit të Interesit më të Lartë (BID)²⁹

Seksioni 1: Vështrim i përgjithshëm

Kampi/Vendndodhja	Rastet e lidhura
Dosja BID Nr.	Rasti i referuar nga
Numri i regjistrimit	
Statusi i fëmijës	Qëllimi i BID-it
I/e pashoqëruar	Zgjidhje e qëndrueshme
Të ndarë	Ofrim i kujdesit
Jetim	Ndarje
Të tjera	Të tjera
	Asnjë nga sa më sipër

Përparësia e rastit (përmend arsyet)

Urgjent	Specifiko
Normal	
Nevojat e veçanta të fëmijës	

Bio-të dhënat bazë të fëmijës (referojuni formularit të regjistrimit)

	Kur është e nevojshme, tregoni nëse informacioni është një vlerësim
Emri i plotë	
Pseudonim	
Mosha	
Gjinia	
Data e lindjes	
Vendi i lindjes	
Data e mbërritjes në vend	
Data e mbërritjes në vendndodhjen aktuale	
Kombësia	
Përkatësia etnike	
Feja	
Adresa e tanishme	
Adresa e regjistruar	
Kujdestari aktual	
Rastet e ndërlidhura	
BID-et e lidhura	
Emri i atit	
Emri i nënës	
Vëllezërit e motrat	

Gjurmimi

Filloi më	Statusi/gjendja
-----------	-----------------

Intervistat

Personi i intervistuar	Numri i intervistave	Data e intervistave

	Emër	Organizata/Institucioni
Intervistuesi		
Oficeri rishikues		
Përkthyesi		

Dokumentacioni i bashkëngjitur
1.
2.
3.
4.

Seksioni 2: Opsionet dhe rekomandimet

Pjesa I – Informacion i shkurtër përmbledhës mbi rastin
<p>Ju lutemi përmbledhni shkurtimisht çështjet kryesore, të tilla si kujdesi aktual, informacioni për prindërit dhe familjen dhe opsionet në shqyrtim.</p>

Pjesa II – Historia para fluturimit/ndarjes

Pjesa III – Situata aktuale

Ju lutemi, përshkruani situatën aktuale të jetesës së fëmijës, duke përfshirë: Kujdesin aktual, kushtet e jetesës, sigurinë, marrëdhëniet me prindërit kujdestarë/vëllezërit/motrat/kujdestarët/anëtarët e tjerë të familjes; Rrjetet e komunitetit, arsimit dhe ndjekja e shkollës; Vlerësimi i moshës dhe pjekurisë së fëmijës, shëndetit fizik dhe mendor dhe çdo vlerësim specifik nevojash. Ju lutemi tregoni se kush është kontaktuar dhe kush ka dhënë informacion, p.sh., fëmija, familja, personat e afërt me fëmijën, kujdestarët, mësuesit, fqinjët, punonjësit socialë/stafi i OJF-ve.

Pjesa IV – Opsionet dhe analizat e disponueshme

Ju lutemi tregoni të gjitha opsionet e disponueshme, mekanizmat shoqërues dhe analizën e secilit. Ju lutemi referojuni të gjithë faktorëve për të rekomanduar atë që është në interesin më të lartë të fëmijës, nën titujt e mëposhtëm: Pikëpamjet e fëmijës, Familja dhe marrëdhëniet e ngushta, Mjedisit i sigurt, Zhvillimi dhe nevojat e personave të cilët kanë dhënë informacion, p.sh., fëmija, familja, personat e afërt me fëmijën, kujdestarët, mësuesit, fqinjët, punonjësit socialë/stafi i OJF-ve.

Rekomandimi përfundimtar

Ju lutemi jepni rekomandimin dhe arsyet përfundimtare.

Emri i vlerësuesit	
Nënshkrimi i vlerësuesit	Data

Emri i recensuesit	
Komentet e recensuesit për raportin	
Nënshkrimi i recensuesit	Data

Sesioni 3: Vendimi i panelit

Ky seksion duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet në seancat e panelit BID. Faqja e nënshkruar më pas duhet të skanohet për të mbrojtur informacionin e përfshirë, të bashkëngjitet në seksionet 1 dhe 2 të formularit dhe të shndërrohet në një dokument Pdf.

Paneli

Miraton rekomandimet
E shtyn vendimin (ju lutemi shpjegoni pse)
Nuk i miraton rekomandimet (ju lutemi shpjegoni pse dhe jepni rekomandimin e panelit)
Rihap çështjen (ju lutemi shpjegoni pse dhe kush e kërkoi rihapjen)
Mbyll çështjen

Arsyet e plota për vendimin

Veprimet vijuese që kërkohen (shënoni dhe specifikoni)

<input type="checkbox"/> Asgjë	<input type="checkbox"/> Referoni fëmijën për <ul style="list-style-type: none"> • Kujdes alternativ • Masa mbrojtëse • Asistencë arsimore • Asistencë psiko-sociale • Ndihma materiale • Asistencë mjekësore
<input type="checkbox"/> Ofroni këshillim për <ul style="list-style-type: none"> • Fëmijën • Prindërit biologjikë • Prindërit kujdestarë 	
<input type="checkbox"/> Ndërmerr gjurmimin zyrtar	
<input type="checkbox"/> Të tjera (shpjego)	

Komente

Nënshkrimet e anëtarëve të panelit

Emri	Organizata	Nënshkrimi
Data		

Zbatimi i BID-it³⁰ ndodh në një sërë kontekstesh të ndryshme në mbarë botën. Udhëzimet BID theksojnë përgjegjësinë kryesore të qeverive për përcaktimin e interesit më të lartë. Megjithatë, nëse autoritetet shtetërore përkatëse nuk janë në gjendje ose nuk dëshirojnë të vendosin procedurat e interesit më të lartë, ose nëse fëmijët e interesuar nuk kanë qasje në procedurat kombëtare të BID-it, UNHCR-ja (së bashku me partnerët) duhet të sigurojë që ky funksion të përmbushet për fëmijët në nevojë. Udhëzimet e UNHCR-së për BID-in përcaktojnë standardet dhe procedurat e nevojshme për kryerjen e procesit BID. Hapat kyç të procesit BID janë:

³⁰UNCHR, 2011. Field Handbook for the Implementation of UNHCR BID Guidelines

- Emërimi i një mbikëqyrësi të BID-së (brenda UNHCR-së ose një agjencie të preferuar partnere).
- Identifikimi i partnerëve të përshtatshëm me ekspertizë përkatëse për mbrojtjen e fëmijëve.
- Identifikimi i anëtarëve të panelit BID dhe krijimi i një paneli BID.
- Krijimi i procedurave standarde të funksionimit (PSF) për BID, të zhvilluara së bashku me partnerët.
- Ofrimi i trajnimeve mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe procesin BID për anëtarët e panelit BID dhe stafin tjetër.
- Vlerësimi i kapaciteteve ekzistuese të stafit dhe punësimi i punonjësve të rasteve dhe personelit për mbrojtjen e fëmijëve sipas nevojës, mundësisht përmes marrëveshjeve të partneritetit.
- Sigurimi i informacionit mbi procesin BID grupeve dhe fëmijëve të komunitetit.
- Krijimi ose forcimi i programit ekzistues për mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë mekanizmat për identifikimin e fëmijëve në rrezik, mekanizmat e referimit, sistemin e menaxhimit të rasteve, etj.



Terre des hommes

Ndihmë për fëmijët.

